

1 E mërkurë, 19 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, thërrisni çështjen ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të  
12 vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 02153 dhe nëse është e  
13 mundur do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04586.

14 Vërej se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi  
15 janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

16 Përpara sesa të ftoj dëshmitarin në sallën e gjyqit ka  
17 disa çështje që duhet të trajtojmë.

18 Së pari, për marrjen aktuale në pyetje dhe përgjithmonë  
19 është e rëndësishme që të flasim ngadalë sepse është e  
20 vështirë për transkriptuesin që të shkruajë transkriptin. Pra,  
21 është e rëndësishme që të bëhet një pauzë ndërmjet pyetjes dhe  
22 përgjigjes në mënyrë të tillë që përkthyesit të na kapin  
23 lidhur me atë se çfarë po themi. E di që është veçanërisht e  
24 vështirë, kur flitet e njëjta gjuhë nga avokati që merr në  
25 pyetje dhe nga dëshmitari. Pra, është shumë e vështirë që të

1 ndiqet nga përkthyesit ajo çfarë thoni ju në qoftë se flisni  
2 me një shpejtësi të tillë. Ju lutem mbajeni parasysh këtë gjë  
3 dhe ju lutem tregojini dhe dëshmitarit që të bëjë një pauzë  
4 prej pesë sekondash përpara sesa t'i përgjigjet pyetjes tuaj  
5 sepse dhe dëshmitari përgjigjet shumë shpejt. Ashtu siç bëj  
6 dhe unë shpeshherë.

7 Dje, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë nga ZPS-ja për  
8 zgjatjen e numrit të fjalëve për një kërkesë të ZPS-së në  
9 lidhje me rregullin 155.

10 Z. Prokuror, nuk e di në qoftë se keni ndonjë gjë për të  
11 shtuar lidhur me kërkesën e bërë dje?

12 Z. BAARLINK: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Nuk kemi  
13 gjë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws.

15 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për të shtuar.

16 Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e z.  
18 Thaçi.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Edhe ne kemi kërkuar të njëjtën  
20 gjë, pra, që të shtohet numri i fjalëve siç u shtua tek pala  
21 tjetër, tek Prokuroria.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e z.  
23 Veseli.

24 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e kemi  
25 parë parashtrimin e tyre. Por mendoj që edhe ne do kemi nevojë

1 për shtimin e numrit të fjalëve.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Mbrojtja e z. Selimi.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Unë gjithmonë preferoj që të jap një

5 version të shkurtuar, megjithatë jam i sigurtë që dhe mua do

6 të më duhen më shumë fjalë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Mbrojtja e z. Krasniqi.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne në parim

10 kërkojmë të njëjtën zgjatje të numrit të fjalëve. Megjithatë

11 kemi edhe një çështje tjetër. Na duhet edhe zgjatja e kohës

12 për një çast në mënyrë që të vendosim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses

14 e pranon shtimin e numrin e fjalëve në përgjigjet e Mbrojtjeve

15 kundër kërkesës së ZPS-së me 12.000 fjalë. Nuk është e thënë

16 që ju t'i përdorni këto fjalë më shumë. Megjithatë në qoftë se

17 do ju duhen i keni aty.

18 Sa i takon pikës tjetër, Trupi Gjykses vëren se dje

19 Mbrojtësi i Viktimave i kërkoi Trupit Gjykses që të nxirrte

20 versionin publik të redaktuar të urdhrit gojor të datës 14

21 korrik 2023 të Mbrojtjes së Viktimave për të marrë në pyetje

22 Dëshmitarin 04746.

23 A keni ndonjë gjë për të shtuar apo për të thënë lidhur

24 me këtë, z. Prokuror?

25 Z. BAARLINK: [Përkthim] Asgjë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e z.

2 Thaçi?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, asgjë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë

5 nga Mbrojtja e Veselit?

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, asgjë.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Faleminderit.

11 Trupi Gjykses riurdhëron klasifikimin si publik të  
12 urdhrit gojor të vetë më datë 14 korrik 2023 sa i takon  
13 kërkesës së Mbrojtjes së Viktimave për të marrë në pyetje  
14 Dëshmitarin 04746 dhe faqja e transkript 5686, rreshti 21 deri  
15 në faqen 5691, rreshti 9. Trupi Gjykses gjithashtu urdhëron  
16 redaktimin e emrit të viktimës dhe të mbiemrit të përmendur në  
17 faqen 56990, rreshtat 11 dhe 22 dhe në faqen 5691, rreshti 5.

18 Këtu përfundon urdhri i dytë gojor.

19 Trupi Gjykses vëren se dje ZPS-ja dha synimin e vetë për  
20 të thërritur Dëshmitarin 03879 për të dhënë dëshmi pas  
21 pushimit gjyqësor duke filluar nga e hëna, 14 gusht 2023, deri  
22 në të enjten, datë 17 gusht 2023. ZPS-ja kërkoi gjithashtu që  
23 për arsye organizative dhe logjistike të përcaktohet një afat  
24 për Mbrojtjen në mënyrë të tillë që të vlerësohet koha që i  
25 duhet Mbrojtjeve për të bërë kundërpyetjet e tyre.

1 Mbrojtja tha që është e vështirë që të bëjnë përcaktimin  
2 e kohës që ju nevojiten deri në përjashtim të rasteve që do  
3 merrnin listën e ZPS-së me dëshmitarë që do të thërriten sipas  
4 rendit të tyre.

5 Trupi Gjykses e ftoi ZPS-në që të komunikonte se cilët  
6 janë dëshmitarët, pesë dëshmitarët e radhës njeri pas tjetrit  
7 sipas rendit që ata do të merren në pyetje nga ZPS-ja deri të  
8 premtën, më datë 28 korrik 2023.

9 Trupi Gjykses rikujton që koha e vlerësuar nga Mbrojtja  
10 për kundërpyetjen mund të cenohet shpejtësinë e procesit  
11 gjyqësor si dhe mund të ketë ndikim gjithashtu edhe në  
12 planifikimin e dëshmitarëve nga ZPS-ja. Për më tepër, Trupi  
13 Gjykses mendon se vlerësimet e sakta të kundërpyetjeve janë  
14 shumë të rëndësishme për ZPS-në për t'i dhënë Mbrojtjes  
15 njoftim në kohë të dëshmitarëve që synon të thërrasë.

16 Trupi Gjykses, si rezultat urdhëron Mbrojtjen që të  
17 rishikojë kohën që i duhet për kundërpyetjet për pesë  
18 dëshmitarët e ardhshëm deri të premtën, data 4 gusht 2023, në  
19 orën 4.00 pasdite.

20 Trupi Gjykses e inkurajon katër Mbrojtjet e të akuzuarve  
21 të angazhohen në komunikime të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe  
22 me ZPS-në.

23 Kjo përfundon urdhrin e tretë gojor.

24 Së fundi, Trupi Gjykses vëren se dje Mbrojtja për z.  
25 Veseli, z. Emmerson kërkoi një urdhër gojor nga Trupi Gjykses

1 sa i takon parametrave që kanë të bëjnë me pyetje që bëhen nga  
2 Trupi Gjykses. Ndërkohë që z. Emmerson nuk dha ndonjë bazë  
3 ligjore për kërkesën e vet, Trupi Gjykses është përgatitur që  
4 të japë udhëzime për palët dhe pjesëmarrësit lidhur me  
5 kundërshtimet për pyetjet gjyqësore.

6 Së pari, ndërkohë që rregullat, rregullorja nuk  
7 parashikon mundësinë e kundërshtimeve të pyetjeve gjyqësore,  
8 Trupi Gjykses është i përgatitur që të pranojë që një palë  
9 mund të duhet që të ngrejë një kundërshtim për një pyetje  
10 gjyqësore në mënyrë që të ruhet mundësia e ngritjes së  
11 çështjes së kundërshtuar në nivel apeli.

12 Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses është i përgatitur që të  
13 pranojë, siç ka bërë deri tani, që të pranojë, pra,  
14 kundërshtimet që kanë palët lidhur me pyetjet gjyqësore. Trupi  
15 Gjykses e bën të qartë se kundërshtime të tilla duhet të bëhen  
16 në një mënyrë që është në përputhej, A, me Kodin e Sjelljes  
17 Profesionale për Avokatët Mbrojtjes, në veçanti, neni 10(A);  
18 B, dhe Urdhrin e Trupit Gjykses për Zhvillimin e Procesit  
19 Gjyqësor në veçanti, paragrafët 115, 106; edhe, pika C, si dhe  
20 vendimin e Trupit Gjykses të Gjykatës së Apelit lidhur me  
21 pyetjet gjyqësore, në veçanti paragrafi 32.

22 Në veçanti kundërshtimet nuk duhet të jenë argumentative  
23 apo që të përmbajnë komente dhe të mos jenë keqpërfaqësuese  
24 ose çorientuese.

25 Trupi Gjykses do të vendosë për kundërshtimet për pyetjet

1 gjyqësore.

2 Trupi Gjykses ka shqyrtuar gjithashtu edhe përshkrimin e  
3 pyetjeve të gjyqësorit nga z. Emmerson për Dëshmitarin 04647  
4 si tendencioze ose të njëanshme dhe që kalojnë përtej kufijve  
5 legjitim të sjelljes së duhur gjyqësore. Pretendimet e thënë  
6 me zë të lartë se Trupi Gjykses, një anëtar i Trupit Gjykses u  
7 mundua që të përfshihej në një argument me të dhe Trupi  
8 Gjykses nuk gjen meritë ose themelshmëri për këto ankesa.

9 Ankesat keqpërfaqësojnë natyrën e pyetjeve dhe nuk marrin  
10 parasysh faktin që Trupi Gjykses mund t'i bëjë pyetje  
11 dëshmitarëve siç e shikon të arsyeshme dhe për të bërë  
12 sqarimet për dëshminë për të zbuluar të vërtetën përfshirë  
13 këtu dhe respektimin e çështjeve që kanë të bëjnë me vendimet  
14 e Trupi Gjykses lidhur me relevancën dhe mbështetshmërinë e  
15 dëshmisë dhe kredibilitetin e dëshmitarëve.

16 Ky është fundi i urdhrit të katër gojor.

17 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se  
18 mund të ngre një çështje shkurtimisht.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Dëshmitari i radhës, Dëshmitari  
21 04586, është planifikuar që të japë dëshmi pas këtij  
22 dëshmitari. Do të ndihmonte shumë ZPS-në në qoftë se mund të  
23 na thotë Mbrojtja sesa kohë do i duhet për kundërpjetet.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e vlerësoj  
25 shqetësimin e Prokurorisë, duke marrë parasysh lejen e dhënë

1 nga Trupi Gjykses nga dje. Kam ndryshuar mendje sot se kisha  
2 planifikuar, pra, më përpara që të mbuloja goxha më tepër  
3 çështje por përderisa përgjigjet që na u dhanë dje ishte që  
4 për shumë gjëra dëshmitari nuk kishte njohuri. I kam shkurtuar  
5 goxha pyetjet e mia.

6 Kështu që mendoj, që do përfundoj deri tek seanca e  
7 paradites sot, domethënë, derisa të bëjmë pushimin e kafes në  
8 orën 11.00.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë  
10 faleminderit.

11 Z. STRONG: [Përkthim] Vlerësimi i z. Veseli nuk ka  
12 ndryshuar nga dje. Besoj 20 minuta, rreth 20 minuta do të  
13 duhen që të marrim në pyetje dëshmitarin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që të  
15 gjithë thatë që ju duhen 20 minuta?

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Mendoj që na  
17 duhet diku një deri në dy orë.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Për neve është 10-15 minuta, jo më  
19 shumë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani znj.  
21 Sekretare, mund ta shoqëroni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

22 Nëse më duhet që t'ju ndërpres, z. Kehoe, për shpejtësinë  
23 me të cilën flisni, nuk kam asgjë personale. Sepse kemi  
24 Sekretarin e Gjykatës që mban transkriptin dhe duhet të  
25 regjistrojë çdo fjalë të mundshme. Për të mos përmendur këtu



1 përkthimin që është shumë i rëndësishëm që duhet t'ju kap në  
2 të gjitha gjërat që thoni.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e vlerësoj  
4 shumë këtë. Ndonjëherë duke qenë që jemi folës të anglishtes  
5 si gjuhë nëne, na merr vrulli edhe ndjehem vërtetë fajtor për  
6 faktin që kemi folur shpejtë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë e  
8 kemi kaluar në një moment ose në një tjetër këtë përvojë  
9 tënden kështu që pa problem.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.  
12 Na dëgjoni mirë?

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Ju kujtoj që ju lutem jepini përgjigje të qartë pyetjeve  
16 që do ju drejtohen me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni  
17 një pyetje, lirisht mundtë kërkonti sqarime ose që të  
18 përsëritet pyetja.

19 Ju lutem thoni gjithashtu edhe bazën e njohurive tuaja  
20 për pyetjet që ju drejtohen nga avokati.

21 Ju kujtoj që jeni nën detyrimin që të tregoni të vërtetën  
22 siç parashikohet në ligjet përkatëse dhe siç është deklaruar  
23 nga ju në deklaratën solemne.

24 Mbani mend që të flisni përpara mikrofonit dhe ju lutem  
25 bëni një pauzë për pesë sekondash në mënyrë të tillë që të

1 dëgjoni deri në fund pyetjen e z. Kehoe dhe në mënyrë të tillë  
2 që përkthyesit t'ju ndjekim, sepse kemi dy gjuhë në të cilat  
3 përkthehet në këtë sallë gjyqi.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se  
6 keni nevojë për pushime, lirisht mund të na e kërkonit këtë  
7 gjë.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të më jepni një copë letër  
9 të mbaj ca shënime, nëse është e nevojshme?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di, në  
11 qoftë se ndokush mund ta ndihmojë.

12 Keni stilolaps apo jo?

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, kam stilolaps.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një  
15 tjetër. Kur të keni përfunduar së mbajturi shënime, ju lutem  
16 duhet t'i lini këtu në mënyrë që t'i shkatërrojmë ato çfarë  
17 keni shkruar.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Patjetër.

19 DËSHMITARI: W02156 [Vijon]

20 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

21 Pyetje të palës tjetër nga Z. Kehoe: [Vazhdim]

22 Z. KEHOE: [Përkthim]

23 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar. Atëherë për ta përsëritur edhe  
24 njëherë atë që tha Gjykatësi Smith, është e rëndësishme që të  
25 lemë ca hapësira ndërmjet pyetjeve të mia dhe përgjigjeve

1 tuaja. Dje kemi folur në të njëjtën kohë goxha shpesh. Kështu  
2 që e mora përsipër përgjegjësinë unë sot për të dy, kështu  
3 është e rëndësishme për neve që të flasim me një ritëm të  
4 përshtatshëm në mënyrë që përkthyesit të na kapin siç duhet.

5 Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen që do t'ju bëj, ju  
6 lutem më thoni ose në qoftë se ju ndërpres ndërkohë që nuk  
7 keni përfunduar, më thoni ju lutem.

8 PË. Në rregull.

9 PY. Atëherë do të kalojmë tani në një periudhë kohe që fillon  
10 në janar dhe besoj që do ta kalojmë shpejt këtë pjesë dhe do  
11 të fillojmë, sigurish, me masakrën e Reçakut më 15 janar. Ju  
12 keni bërë shumë hetime sa i takon rrëmbimeve të ndryshme,  
13 kidnapimeve të ndryshme, që kanë ndodhur në janar të 1999.

14 Kështu ka ndodhur, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Me kidnapimet dhe hetimet që kanë ndodhur, siç na thatë  
17 në deklaratën tuaj, këto kanë ndodhur pas Reçakut apo jo?

18 PË. Për kë kidnapime e keni fjalën posaçërisht?

19 PY. Pra, e kam fjalën për ato që keni përmendur për  
20 deklaratat tuaja të Saleviçit, Krasniqit, të dy personave me  
21 mbiemrin Krasniqi, Imer Saleviçit. Kam përshtypjen që këto i  
22 keni përmendur, i keni dhënë dhe keni thënë që janë kidnapuar  
23 pas masakrës së Reçakut, është kështu?

24 PË. Mesa më kujtohet Saveliçi ka qenë në fund të shkurtit.

25 Kanë qenë dy kidnapime, me ç' duket, nga UÇK-ja, njëri është

1 Morin Elshani, në fillim të shkurtit. Dhe ka pasur shumë  
2 kidnapime të tjera të civilëve shqiptarë nga forcat serbe ose  
3 forcat speciale serbe. Mesa më kujtohet, ka qenë, pak a shumë,  
4 në të njëjtën rreth të njëjtës periudhe.

5 PY. Atëherë si një pikë që na lidhë me masakrën e Reçakut,  
6 sepse do kemi shumë pyetje të cilat na lidhin me këtë pikë,  
7 pra, le të shohim pak komentet që keni bërë "Ashtu siç është  
8 parë, ashtu është treguar", volumi 1.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për procesverbal ky është  
10 dokumenti SPOE00198089 deri në 00198366. Është në faqen  
11 098164.

12 PY. Shkruhet në Volumin 1:

13 "Vrasjet masive në komunën e Shtimjes më 15 janar 1999  
14 ishte një ngjarje përmyllëse si sa i takon njohjes  
15 ndërkombëtare dhe shkeljet e të drejtave të njeriut ishin në  
16 pikun e vet përgjatë të gjithë konflikteve në Kosovë dhe kanë  
17 ndodhur dy incidente të tjerë atë muaj në komunën e Gjakovës  
18 dhe në Rugovë dhe Rakovinë. Dhe këto ishin shumë treguese  
19 lidhur me atë çfarë ka ndodhur në periudhën e marsit më vonë.  
20 Prania më e shpeshtë e misionit verifikues të OSBE-së ë  
21 Kosovë, gjithsesi, ishte mbështetur në vrasjet që kishin  
22 ndodhur mbi bazë individuale".

23 A pajtoheni me këtë, zotëri?

24 PË. Të nderuar Gjykatës, unë nuk mund të kujtoj tani, nuk më  
25 kujtohen shembuj e asaj çfarë konsiderohen si vrasje masive në

1 periudhën përpara Reçakut, që unë dyshoj që kanë përcaktuar  
2 rëndësinë e Reçakut. Kështu që kjo duket sikur është një  
3 përshkrim i saktë.

4 PY. Nëse do ju sillja në vëmendje komentet e eprorit tuaj, z.  
5 Ringgard që ka dhënë dëshmi në çështjen kundër Limajt.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe për transkript këto janë faqet  
7 3348 deri në 3540, në 3532 është faqja përkatëse, rreshtat 12  
8 deri në 25.

9 PY. Pyetja është kjo:

10 "Z. Ringgaard, faleminderit për durimin. Tani, që na  
11 thatë që Misioni i Verifikimit ka marrë informacion për  
12 kidnapimet nga UÇK-ja, për të ashtuquajturit bashkëpunëtorë.  
13 Tani mbështetur në informacionin që keni marrë, që ka marrë  
14 edhe UÇK-ja, a keni pasur mundësi që të përcaktoni se kishte  
15 elementë të pabindur për të përdorur këste si shprehje të  
16 cilët kanë përdorur politika më të gjera për të punuar atje?

17 "PË. Informacioni që kemi marrë nga oficerët ndërlihdës  
18 së UÇK-së ishte që ata ishin në dijeni të faktit që kishte  
19 elementë të pabindur dhe ndonjëherë e kishin dhe ata të  
20 vështirë që të kontrollonin të gjitha rastet e hakmarrjeve  
21 personale dhe të çështjeve ose të ngjarjeve të tilla".

22 Tani, a ju kujtohet, mbasi ju lexova atë çfarë ka thënë  
23 z. Ringgaard?

24 PË. Mendoj që ishte një çështje e zakonshme duke marrë parasysh  
25 mjedisin dinamik dhe delikat të asaj kohe.

1 PY. Ju keni komentuar dhe kjo jepet në provën materiale 230.  
2 Pra, dokumenti P230. Ju keni folur gjatë kësaj periudhe dhe ju  
3 vëreni dhe kjo jepet në paragrafin 35, ju thoni:

4 "Që në atë kohë kishte incidente për ditë, kishte  
5 armëpushime që shkeleshin gjithandej, kishte shumë raportim të  
6 gjërave të tilla që ndodhnin".

7 Pra, do të ishte e drejtë që të thuhet që gjatë kësaj  
8 periudhe kohe pas Reçakut, gjërat u bënë shumë kaotike si në  
9 terren dhe u bënë edhe shumë kaotike dhe të vështira dhe për  
10 juve që duhet të raportoni?

11 PË. Gjërat ishin kaotike që nga momenti që ne arritëm,  
12 mbërritëm në Rahovec. Domethënë, të paktën flas për ekipin  
13 tonë. Që prej ditës së parë, ne kemi qenë shumë të zënë me  
14 punë që nga lindja e diellit derisa perëndonte dita. Pra, e  
15 kishim të pamundur që të punonim ndryshe. Pra, domethënë, që  
16 në momentin që kemi mbërritur ka pasur ka pasur incidente të  
17 posaçme, ka pasur incidente konkrete, ka pasur të shtëna,  
18 vrasje, shkelje të drejtave të njeriut, arrestime, kemi gjetur  
19 njerëz të vdekur, si dhe kishim edhe punën e përditshme të  
20 patrullimit përveç këtyre. Ne të gjithë ishim të përfshirë në  
21 këto procese pune.

22 Mund të ketë pasur, pra, pas kësaj ka ndodhur Reçaku.  
23 Megjithatë do më duhet që të shikoj statistikat raportimet.  
24 por me aq sa më kujtohet nuk ka pasur një ditë të vetme kur të  
25 gjithë ne si ekip nuk ishim të zënë dhe që nuk po merreshim me

1 rezultatet e një konflikti goxha të agravuar dhe të rëndë në  
2 mes të të cilit ne ishim dërguar.

3 PY. Z. Ledwidge, e vlerësoj shumë kohën që keni kaluar atje  
4 dhe përpjekjet që keni bërë, orvatjet tuaja dhe të ekipit  
5 tuaj. Pra, sigurisht ajo çka po bëjmë neve lidhet me atë çfarë  
6 keni bërë ju, të nderuar zotërinj, në atëkohë kaq shumë të  
7 vështirë, kështu që e vlerësoj plotësisht.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

9 PY. Se po ju bëj pyetje gjatë kësaj periudhe që janë disi të  
10 shpërndara. Megjithatë gjatë kësaj periudhe, pas Reçakut,  
11 autoritet ushtarake serbe filluan stërvitjen e tyre të dimrit  
12 në jug të Mitrovicës, a ka ndodhur kështu?

13 PË. Unë nuk jam vendosur në Mitrovicë, me gjithë respektin.  
14 Më kujtohet një stërvitje brigade që ka ndodhur në zonën ku  
15 ishim të vendosur ne, jo shumë larg nga Shtimja. Unë vetë nuk  
16 mund të dëshmojë për intensifikim të pranisë ushtarake ose të  
17 stërvitjeve ushtarake në zonën tonë sepse, siç thashë,  
18 domethënë, unë kam qenë në Rahovec dhe gjërat kanë qenë goxha  
19 të ngjeshura në çdo rast domethënë. Në qoftë se ju thonë që ka  
20 pasur stërvitje dimri nuk është se kam ndonjë arsye për të mos  
21 u pajtuar me juve.

22 PY. Është raportuar kjo gjë përsëri në librin "Ashtu siç  
23 është parë, ashtu është treguar", në dokumentin SPOE00198367  
24 në 198834 dhe 198851, ku citoj "Stërvitjet ushtarake filluan  
25 në jug të Kosovës në komunën e Mitrovicës në fund të

1 shkurtit". A keni ndonjë arsye për të mos u pajtuar me mua.

2 PË. Në fund të shkurtit? Nuk kam arsye për të mos u pajtuar.

3 Megjithatë, ka pasur aktivitete të ngjeshura ushtarake me

4 ç'kujtohet edhe në dhjetor dhe në atë kohë ne jemi vendosur

5 aty dhe për shkak të aktiviteteve na janë ulur kapacitetet.

6 Kështu që nuk kam arsye për të mos u pajtuar me ju.

7 PY. Dhe kjo çoi, sigurisht, në fushatën ushtarake serbe që

8 filloi në shkurt dhe në mars dhe vazhdoi për shumë muaj të

9 tjerë në zonën e Kosovës, a ka ndodhur kështu?

10 PË. Po, siç e thoni ju.

11 PY. Mendoj që ju, personat, njerëzit e OSBE-së dhe në librin

12 "Ashtu siç është parë, ashtu është treguar" e raportoni këtë,

13 pra, thoni që në periudhën nga marsi deri në qershor 1999,

14 ish-Jugosllavia, pra, forcat serbe dëbuan rreth 863.000

15 shqiptarë të Kosovës nga Kosova.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe përsëri për procesverbal kjo

17 thuhet në SPOE0019823, 243. "Ashtu siç është parë, ashtu është

18 treguar".

19 PY. Dhe më pas në këtë dokument më poshtë thoni që 90 për

20 qind e popullsisë shqiptare, rreth 1.4 milion njerëz janë

21 zhvendosur nga konflikti, pra, nga zonat e konfliktit deri në

22 qershor të 1999. A ka ndonjë arsye që të vini në pikëpyetje

23 statistikat e OSBE-së në këtë libër që e citova më sipër?

24 PË. Jo, përkundrazi, e konfirmoj këtë. Ekipet tona pas

25 dëbimit, janë zhvendosur në Shqipëri. Unë vetë kam qenë njëri



1 prej këtyre personave. Këto janë fakte që janë të vërteta dhe  
2 sigurisht që i pranoj plotësisht.

3 PY. Pra, duke filluar në shkurt e duke vazhduar më tej në  
4 mars, prill edhe me radhë, popullsia shqiptare e Kosovës është  
5 dëbuar me forcë nga forcat serbe, qofshin ato forcat  
6 ushtarake, policia ose paraushtarake, paramilitarët apo jo?

7 PË. Po, disa prej këtyre dëbimeve i kam parë me sytë e mi.

8 PY. Në qoftë se do shohim provën materiale, ose dokumentin që  
9 Prokuroria e kërkoi që të paranojë në provë materiale, e ka  
10 fjalën për provën materiale 234. Do kërkoja që të paraqitej në  
11 ekran. Ky është kapitulli që ka të bëjë me Rahovecin për të  
12 cilin juve folët dje me Prokurorin.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk besoj se ka një përkthim në  
14 shqip të këtij dokumenti. Mendoj që është vetëm në versionin  
15 në gjuhën angleze.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Mendoj se ka.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Mbase. Ta paraqesim në ekran ju  
18 lutem. Faleminderit, znj. Sekretare. Nëse mund të shohim  
19 dokumentin SPOE000198576. Në këtë faqe, ju lutem.

20 PY. Kjo ka të bëjë me raportimin për Rahovec.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Dëshiroj që të zmadhohet paragrafi  
22 në fund fare të dokumentit që fillon me "Në prill..."

23 PY. Z. Dëshmitar, në qoftë se në çdo moment dëshironi që të  
24 lexoni pjesë të caktuara të këtij raporti, na e thoni këtë  
25 gjë.

1 PË. Po.

2 PY. Në këtë pjesë flasim për Rahovecin. Në këtë paragraf  
3 thuhet:

4 "Në Prill" të 1999, "kishte sinjale të raportuara  
5 ngatërruese për sa i takon synimeve të autoriteteve serbe, ku  
6 ushtria jugosllave pretendohet që po përpiquej që të  
7 inkurajonte shqiptarët e Kosovës që të ktheheshin në qytetet e  
8 tyre, qytezat e tyre dhe situata ishte që njerëzit kur  
9 ktheheshin, ditën e nesërme ju kërkohet përsëri që të  
10 përgatiteshin për t'u dëbuar dhe për t'u nxjerrë nga vendi për  
11 të çuar në drejtim të Shqipërisë. Pra, kishte fjalë se  
12 ekzistonte një listë e zezë dhe raportet etiketonin  
13 profesionistë ose njerëz të cilët ishin të lidhur me LDK-në  
14 dhe UÇK-në..."

15 Po ashtu mund të lexoni pak më poshtë:

16 "Dhe rastin e një gruaje, një 86 vjeçare e cila u gjet e  
17 vdekur me një plumb në kokë dhe me trupin e saj dhe të një 50  
18 vjeçari tjetër brenda shtëpisë".

19 A ju kujtohet kjo gjë, Dëshmitar?

20 PË. Mendoj që kështu do ketë ndodhur. Mendoj që ka pasur dhe  
21 raste të tjera gjatë asaj kohe. Kështu që nuk është se më  
22 kujtohet ky paragraf konkret. Por nuk do çuditesha në qoftë se  
23 do më thoni që unë kam dhënë kontributin tim për t'u shkruar  
24 ky raport. Nëse më lejoni?

25 PY. Natyrisht.

1 PË. Në këtë kohë ishin ose në Maqedoni ose në Shqipëri. Unë  
2 dhe kështu ne po raportnim, pra, bazuar në atë që na thuhej  
3 nga refugjatët. Natyrisht, s'kishim arsye që të dyshonim në  
4 ato që na tregonin ata, por nuk ishim të pranishëm në terren.

5 PY. Dhe kuptoj që këto informacione i ke përfshirë në këtë  
6 raport, që i cili pastaj është publikuar?

7 PË. Ne jemi dëbuar si persona të padëshiruar aty.

8 PY. Në një moment të caktuar këtë informacione i keni futur  
9 në raportin "Treguar ashtu siç është parë" që është pjesë e  
10 provave të Prokurorisë?

11 PË. Është kjo pjesë e provave 234 të Prokurorisë? Po, e kemi  
12 bërë këtë me ekipin tonë.

13 PY. Thjesht, ju kujtoj sa për qartësim, ky është një dokument  
14 që Prokuroria e ka paraqitur si provë me juve dje. Që të jem i  
15 qartë. Në rregull?

16 Kalojmë tek fshati i rrallës, Bellacerkë.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mund ndalim të shohim në pjesën  
18 më sipër 198577, nuk besoj që është faqja vijuese.

19 PY. Paragrafi i dytë flet për Bellacërkën.

20 "Pas pak orësh pas fillimit të bombardimit të NATO-s mbi  
21 forcat jugosllave, më 24 mars, forcat serbe pushtuan fshatin  
22 pjesa dërrmuese e popullsisë që në atë kohë përfshinte  
23 personat e zhvendosur brenda vendit nga zonat përreth, filluan  
24 të..."

25 Nuk jam i sigurtë për këtë fjalë.

1 "Në orët e mëhershme të datës 25 mars, Ushtria Jugosllave  
2 dhe policia arritën në Bellacërkë me tanke, u pozicionuan mbi  
3 një kodër dhe filluan të bombardonin 850 shtëpi dhe të digjnin  
4 fshatin. Fshatarët ikën në drejtime të ndryshme por shumë nuk  
5 arritën ta bënin këtë gjë. Njerëzit u grumbulluan, u vodhën  
6 lekë, para, në shkëmbim që t'i linin të gjallë disa nga  
7 meshkujt. Forcat serbe, pastaj forcat serbe grumbulluan një  
8 grup për përreth 50 burrash dhe pasi ju morën dokumentet e  
9 identitetit, i ekzekutuan ata në vend".

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Mund të kalojmë tek faqja tjetër.

11 PY. Në fund të kësaj faqeje, kur fillon me "Një burrë, emri i  
12 të cilit nuk dihet..." dhe:

13 "Një mashkull, emri i të cilit nuk dihet që ishte kthyer  
14 në Bellacërkë natën përpara për t'i kërkuar të mbijetuarit në  
15 anën e lumit thotë në një intervistë që kishte zbuluar 13  
16 trupa, të gjithë të një familjeje. Me këto trupa kufomash  
17 ishte një djalë 2 vjeçar që kishte qëndruar aty 15 orë dhe  
18 kishte mbijetuar".

19 Këto janë raportet që kanë ardhë nga Bellacërka. Dhe ju  
20 na thatë që këto i keni grumbulluar këto tregime nga qendrat e  
21 refugjatëve pasi ishit dëbuar si person i padëshiruar në mars?

22 Z. BAARLINK: [Përkthim] E di që z. Kehoe po bën pyetje  
23 bazuar në provat e paraqitura nga Prokuroria. Nuk e  
24 kundërshtoj këtë, por kemi një dispozitë në kodin e sjelljes  
25 për sa i përket marrjes në pyetje. Thjesht në pjesën që

1 përputhen me paragrafin 1 dhe 4 të kodit të zhvillimit të  
2 procedurës, në pikë janë të qarta.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo është provë e Prokurorisë dhe  
4 unë po marrë, po bëj kundrapyetje bazuar në këtë dokument.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet poshtë  
6 kundërshtimi. Vazhdoni.

7 Z. KEHOE: [Përkthim]

8 PY. Pra, ky ishte raport që morët nga refugjatët, pasi që ju  
9 ishit larguar nga zona dhe mbasi organizata jote filloj të  
10 intervistonte ata a po të marrë tregimet e tyre, është saktë?

11 PË. Në këtë pjesë, në këtë rast, pjesërisht. Në rastin e  
12 Bellacërkës, më kujtohet shumë qartë, do të doja të kujtoj  
13 këtu kolegun tim Irfan Popaj që u vra atje, guximin e tij unë  
14 nuk e kam harruar. Unë personalisht me kolegët e mi kemi  
15 hetuar vrasjen e tij dhe vrasjet e tjera. Dhe rezultatet e  
16 hetimit tonë besoj që janë të paraqitura këtu dhe këto janë  
17 hetime të rezultateve që janë bërë pas bombardimit të NATO-s.

18 Gjatë kësaj kohe, ekipi jonë ka zhvilluar hetime, siç  
19 është kjo që po shkruhet këtu, lidhur me të gjitha vendet ku  
20 janë kryer vrasjet kryesore në zonën tonë dhe shumë të tjera  
21 që janë të përfaqësuara më pak.

22 PY. Vazhdojmë më tej në dokument në qoftë se mundemi. Në të  
23 njëjtën faqe P234, vazhdojmë në fund të faqes ku flitet për  
24 fshatin Celinë. A e shqiptoj saktë, Celinë?

25 PË. Celinë.

1 PY. Celinë?

2 PË. Celinë saktë.

3 PY. Dhe paragrafi i dytë:

4 "Policia serbe dhe ushtria serbe ishin të pranishëm rreth  
5 Celinës çdo ditë për disa ditë me radhë, duke filluar nga  
6 rreth datës 23, 24 mars deri më të paktën 29 mars 1999. Gjatë  
7 kësaj kohe shtëpitë janë plaçkitur dhe shkatërruar familjet u  
8 ndanë dhe u plaçkitën dhe shumë njerëz u vranë. Meshkujt u  
9 rrahën, të cilëve u morën kartat e identitetit, u vodhën  
10 paratë nga ata nën kërcënim për jetë dhe ndërsa të tjerë u  
11 qëlluan dhe u vranë".

12 Kalojmë në faqen vijuese, flasim akoma dhe këtu për  
13 Celinën, vazhdon në fshatin Celinë:

14 "Më datë 26 -- kërkoj ndjesë. Më 26 mars filluan përsëri  
15 të shtënat. Fshatarët që kishin ngelur ikën në male ku ishin  
16 rreth 4.000 vetë nga fshatrat përreth. Disa nga njerëzit ikën  
17 në fshat për të marrë ushqim. Kur u kthyen ata raportuan se  
18 kishin gjetur kufomat në vende të ndryshme. Një mashkull që u  
19 kthye në Celinë nga fshatrat me një grup meshkujsh të tjerë  
20 thanë që kishin varrosur 86 kufoma që të gjitha në vende të  
21 ndryshme".

22 Ishte ky rezultat i hetimit që ju dhe ekipi juaj e keni  
23 bërë pasi jeni kthyer nga kampi i refugjatit?

24 PË. Besoj që janë të dyja, në të dyja rastet. Nuk më kujtohet  
25 saktë ,po besoj që ishin të dyja.

1 PY. Çdo herë që diçka nuk ju kujtohet është në rregull  
2 mjafton të na tregon.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë në faqen tjetër,  
4 në fund të faqes.

5 PY. Këtu ka të bëjë me disa fshatra, Krusha e Madhe dhe  
6 Krusha e Vogël.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Po kalojmë në faqen tjetër.

8 PY. Besoj që këtu flitet për Krushën e madhe në këtë pjesë.

9 "Ushtria Jugosllave dhe policia më duket se kanë qenë të  
10 pranishëm në ndërprerjen dhe zonën përreth për një periudhë  
11 kohore katër pesë ditë duke filluar nga data 24 mars. Pas  
12 rrethimit dhe bombardimit të dy fshatrave ushtria jugosllave  
13 dhe policia kanë hyrë dhe kanë filluar të djegin  
14 sistematikisht dhe të plaçkisnin shtëpitë e shqiptarëve  
15 kosovar që jetojnë aty. Në një periudhë kohore tre ditore  
16 forcat serbe bashkë me civilët serbë kanë plaçkitur dhe djegur  
17 shtëpitë në këtë zonë. Gjatë kësaj kohe më shumë se 1.000 vetë  
18 që ishin në Krushën e Vogël, shumë nga zonat përreth që  
19 lëviznin nga një vend në një tjetër ... grupe të tjera njerëz  
20 kanë ikur në male ku mund të shihnin ushtrinë serbe, policinë  
21 dhe civilët serbë që i digjnin dhe i plaçkisnin shtëpi ...  
22 makinat private janë larguar nga Krusha e Vogël të mbushur me  
23 sende të vjedhura nga shtëpitë. Pasi që shtëpitë janë  
24 plaçkitur ndërtesat janë djegur. Natën disa nga fshatarët janë  
25 kthyer dhe janë fshehur nëpër bodrume".

1 Kalojmë, mos e lexojmë paragrafin vijues, kalojmë tek  
2 tjetri.

3 "27 mars fshatarët panë policinë që erdhi me kamion të  
4 mbushur me kufoma dhe i kanë hedhur ata në lumë. Fshatarët  
5 kanë qëndruar në shtëpitë tyre rreth 31 marsit përsëri policia  
6 filloi të detyronte fshatarët që kishin ngelur që të  
7 largoheshin dhe ata i kanë parë kamionët që disa nga trupat e  
8 vdekur që ishin hedhur nga kamioni ishin akoma afër lumit. Më  
9 vonë KFOR-i ka hequr një kamion nga lumi, janë gjetur kocka në  
10 pjesën e prapme".

11 Vazhdojmë në faqen tjetër.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse shkojmë  
13 më lart, përpara se të shkojmë më larg, a mund të na tregoni  
14 ku po synoni të arrini me këtë seri pyetjesh me qëllim që dhe  
15 dëshmitari ta dijë se ku po shkoni. Besoj se kemi qenë të  
16 qartë se kjo duhet të ketë ndikim në strukturën e UÇK-së apo  
17 lidhur me atë që pretendohet të ketë ndodhur, lidhur sa i  
18 përket këtyre katër të akuzuarve.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, z. Gjykatës.

20 PY. Do t'ju bëj këtë pyetje. Si rezultat, jo në tërësi, po  
21 pjesërisht i këtij aktiviteti nga forcat jugosllave, kur  
22 shqiptarët e Kosovës, mbi 600.000 shqiptarë të Kosovës u  
23 kthyen, ju apo organizata juaj kishte raportuar se kishte një  
24 përbërës hakmarrjeje i rëndësishëm, shumë i madh i  
25 konsiderueshëm, që shpjegonte një pjesë të madhe të krimeve që



1 ndodhnin në zonën ku ishit ju.

2 Kjo është arsyeja për të cilën ju lexova këtë, për në  
3 mënyrë të detajuar, jo vetëm krimet individuale, natyrisht,  
4 UÇK-ja nuk ishte aty për t'i mbrojtur këta njerëz por edhe ajo  
5 që ndodhi më vonë, më pastaj.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më korrigjo  
7 nëse s'e kam kuptuar mirë, ajo që thoni ju është që hakmarrja  
8 është kryer nga ana e serbëve?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, hakmarrjen e bëjnë ata që po  
10 ktheheshin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju nuk e  
12 përmendët fare këtë fjalë hakmarrje.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të flisja për këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere  
15 përmendeni.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] E kuptoj.

17 PY. Atëherë kalojmë, kthehemi tek aspekti i shqiptarëve që  
18 ktheheshin. Kishte një hakmarrje të lartë tek këta njerëz që  
19 ktheheshin, sepse familjet e tyre ishin vrarë, shtëpitë ishin  
20 djegur, sende ishin vjedhur plaçkitur, shokë, miq ishin vrarë,  
21 a është e saktë?

22 PË. Nuk mendoj që është e paarsyeshme. E njëjta gjë vlen edhe  
23 për kidnapimin dhe vrasjen e 47 serbëve, romëve dhe  
24 shqiptarëve të cilët u vranë në fund të korrikut 1998. Kjo  
25 është një prej hipotezave për të cilën po punonim ne.

1 PY. Dhe arsyeja në provën 230 paragrafi 16, ju keni shënuar  
2 që një pjesë e madhe e kohës, e punës e NVK-së ishte kur u  
3 kalua duke u marrë me shqiptarë që ishin zhdukur dhe të  
4 vdekurit. Dhe në paragrafin 16 përsëri thoni.

5 Arsyeja për këtë ishte, se ata ishin në numër më të madh  
6 shqiptarët, pra, rreth 7.000 shqiptarë të zhdukur, shqiptarë  
7 të Kosovës.

8 PË. Po, rreth 1.000 serbë të zhdukur, që përfaqësojnë  
9 statistikisht ndoshta në proporcion pak më të lartë. Po nuk  
10 kundërshtoj fare mizoritë që janë kryer, vrasjet në masë dhe  
11 nga forcat serbe.

12 Disa elementë të UÇK-së kanë bërë të njëjtën gjë  
13 megjithatë.

14 PY. Nuk prisja nga ju që të thoni një gjë të tillë. Por po ju  
15 them që ka pasë shumë, më shumë shqiptarë të Kosovës dhe ju si  
16 OSBE i keni kaluar, është dashur që t'i kushtoni shumë më  
17 shumë kohë për të kërkuar për këta persona të zhdukur, kërkuar  
18 këta persona të zhdukur?

19 PË. Në cilën periudhë kohore në misionin tonë? Në disa vite  
20 më vonë, mund të them se edhe dy periudhat kohore, përpara  
21 bombardimit, gjatë bombardimit, tre periudha, më fal dhe pas  
22 bombardimit, kështu ka qenë saktësisht sepse, siç e thatë edhe  
23 ju, numri i viktimave, numri i personave të vrarë nga  
24 autoritet serbe ishte më i madh sesa numri i vrarë nga UÇK-ja.

25 PY. Dhe kjo mund të jetë arsyeja, që i keni kushtuar shumë më

1 shumë kohë - në provën P230 paragrafi 16 - kohë shumë më shumë  
2 për të hetuar të zhdukurit dhe të vdekurit shqiptarë?

3 PË. Sapo e thashë këtë.

4 PY. Dhe kjo s'ka asgjë, s'ka të bëj fare me faktin që dikush  
5 mund të jetë pro apo kundër shqiptarëve apo serbëve?

6 PË. Tani dhe këtë do thoja unë. Për ne ishin thjesht persona  
7 të zhdukur.

8 PY. Sot që jeni këtu dhe bëtë disa komente për ambasadorin  
9 Walker, për shembull, sot që jeni këtu, a po na thoni që  
10 ambasadori Walker apo puna e tij me OSBE-në ishte për njërin  
11 anë apo për tjetrën?

12 PË. Cilit koment po i referoheni?

13 PY. Po flas për komentin që i keni bërë lidhur me udhëheqjen  
14 e lartë.

15 PË. Cilën deklaratë? Sepse deklaratën e parë e kam  
16 korrigjuar. E kam korrigjuar qartësisht.

17 PY. Dhe e di e kam parë këtë korrigjim. Është P233. Keni  
18 deklaruar:

19 "...në atë kohë ai besonte se MVK-ja nuk ishte interesuar  
20 në serbë politikisht, por besonte se ishte për shkak të disa  
21 presioneve politike. Keni deklaruar që ka qenë një tendencë e  
22 natyrshme për të punësuarit më të rinj që të fajësojnë eprorët  
23 e tyre...".

24 Në atë kohë, mund të mos keni kuptuar presionin politik  
25 në nivelin më të lartë.

1 Pra, se të jem i qartë, siç po thoni sot, ambasadori  
2 Walker nuk ka qenë --  
3 PË. Ajo që mund të them është që më pas në retrospektivë 25  
4 vjet më vonë në përvojë të kufizuar, kuptoj që në nivelet më  
5 të larta të udhëheqjes ndërkombëtare disa herë janë bërë disa  
6 kompromise. Dhe kjo është e kuptueshme për të gjithë. Këto  
7 kompromise janë shpesh kuptuar -- nuk kuptohen nga ata që janë  
8 më poshtë tyre, në nivele më poshtë edhe natyrisht do e  
9 imagjinoja që kjo gjë mund të ketë ndodhë edhe në atë kohë.  
10 PY. Pra, qëndron më pranë deklaratës që i keni dhënë  
11 Prokurorit?  
12 PË. E saktë.  
13 PY. Kthehemi tek aspekti i hakmarrjes edhe njëherë. Ka pasur  
14 mitin hakmarrje te shqiptarët e Kosovës që ktheheshin. Kjo  
15 gjendet qartësisht në raportin "Ashtu siç është parë, siç  
16 është treguar", duke filluar me parafjalën e z. Kouchner. Në  
17 qoftë se dëshironi edhe mund t'jua lexoj?  
18 PË. Jo, s'ka nevojë. Nuk besoj, meqenëse po kërkoni komentin  
19 tim sa i përket ambasadorit Kouchner, hakmarrja ka qenë një  
20 element i pranueshëm në të gjithë konfliktin që nga viti 1998  
21 në vijim pastaj qartësisht, që nga fillesat e vitit 1998.  
22 PY. Volumi 2 i raportit "Ashtu siç është parë, siç treguar"  
23 faqen 1529 në 1871, faqe 1523. Thotë:  
24 "Hakmarrja dhe frika janë të pranishme gjithandej".  
25 Kjo është e në përputhje me atë që sapo thatë.

1 PË. Këto ishin pjesë përbërëse karakteristike të konfliktit  
2 që nga fillimi i konfliktit. Nëse më lejoni të mbaroj  
3 përgjigjen time. Hakmarrja, sipas përvojës time, hakmarrja dhe  
4 frika ishin në të dyja të pranishme që nga fillimi i  
5 konfliktit.

6 PY. Për pyetjen më ndërprisni kur e tejkaloj.

7 PË. U detyrova ta bëj këtë disa herë dhe që t'ju ndërpres.

8 PY. Dhe kërkoj ndjesë, paraprkisht, nuk synoj të bëj këtë  
9 gjë nëse ndodhë përsëri.

10 Pyetja është e qartë, pra, po më lejoni të lexoj atë që  
11 Shaun Byrnes ka thënë lidhur me atë që po ndodhë. Po përpara  
12 se të bëjmë atë, në fakt, ka qenë një element dhe këtu po flas  
13 për periudhën pas konfliktit në Prizren dhe zona të tjera ku  
14 keni qenë. Ka ekzistuar një element i bandave kriminale që  
15 votohen aty?

16 PË. Natyrisht.

17 PY. Dhe po në të njëjtën mënyrë ka ekzistuar një element  
18 kriminal që vinte nga Shqipëria që përfitonte nga situata e  
19 rrëmujës në Kosovë pas konfliktit?

20 PË. Them "sigurisht" sepse përvoja ime lidhur me këtë pikë,  
21 ka filluar me kthimin tonë nga Shqipëria, siç e deklarova,  
22 besoj, në deklaratën e parë, ku kam vërejtur, dëgjuar  
23 pretendime të vajzave të reja që merreshin për qëllime të  
24 trafikimit me qenie njerëzore nga trafikantë shqiptarë. Ashtu  
25 siç shefi i inteligjencës së UÇK-së në zonën tonë nuk i

1 interesonte kjo gjë.

2 UÇK-ja në zonat pas konfliktit, siç është në Kosovë, siç  
3 është rasti në Kosovë, keni gjithmonë praninë e krimit të  
4 organizuar që përfiton nga kaosi dhe situata. Ka pasur dhe  
5 dyshime për të dhe për vrasës në seri jashtë elementëve  
6 politik, pra, që ndodhnin, po këto janë --

7 PË. Pra, ju thoni --

8 PY. -- kemi krimi i organizuar, kemi element kriminal të  
9 gjithë që vinin pas konfliktit, pra, saktë?

10 PË. Besoj që krimi i organizuar ka qenë një karakteristik  
11 përpara konfliktit, e kam fjalën para bombardimeve të NATO-s.  
12 Kjo ka qenë dominuar nga bandat serbe në bashkëpunim, besoj,  
13 me shqiptarë. Pastaj kanë vazhduar duke përfituar nga mungesa  
14 e ligjit e rendit dhe kaosi, vazhdojnë deri sot.

15 PY. Dhe kjo mungesë e ligjit e rendit që ndodhte -- ta heq  
16 këtë pyetje. E dini se për shembull, uniformat e UÇK-së ishin,  
17 mund të gjendeshin kudo në Kosovë dhe në kufirin me  
18 Shqipërinë, e dini këtë?

19 PË. Se dyshoj fare që kështu ka qenë.

20 PY. Përveç krimit të organizuar, elementë kriminalë, banda të  
21 armatosura, kishit aty edhe kishin edhe mund të gjeje dhe  
22 uniforma të UÇK-së, njerëzit mund të gjejnë.

23 PË. Uniforma ushtarake, po. Se nuk jam i sigurtë që UÇK-ja  
24 kishte uniformë të vetën.

25 PY. Në këtë boshllëk ishte event i zbatuesit të UNMIK-ut që

1 duhet të ushtronin këtë, të mbanin rend?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe kjo në fakt nuk ka ndodhur të mbanin rend, pra?

4 PË. Kur thoni ju, për çfarë e keni fjalën thoni "nuk ka  
5 ndodhur një gjë të tillë"?

6 PY. Pajtoheni me mua që çdo zbatim i ligjit, për sa i përket  
7 zbatimit të ligjit, UNMIK-u ka qenë shumë i ngadaltë në  
8 realizimin e kësaj?

9 PË. Besoj që është shumë e drejtë të thuhet një gjë e tillë.  
10 Ka pasur përpjekje të bëra nga ushtarët e KFOR-it në përpjekje  
11 për të zvogëluar këtë rrëmujë, pra, këtë kaos por me sukses të  
12 kufizuar në disa vende dhe siç dihet.

13 PY. Të nxjerrim në ekran.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] SITF00385157 deri tek 178. Është  
15 raporti i ekipit të vlerësimit të Kosovës në 25, 26 qershor  
16 1999. Dhe nëse mund të kalojmë tek paragrafi i parë.

17 PY. Pas fjalisë së tretë "Situata në Mitrovicë" dhe ja shihni  
18 këtu?

19 PË. Po, e shoh.

20 PY. Këtu shënon:

21 "Gjendja në Mitrovicë është e tendosur serbët bllokojnë  
22 gjysmën e qytetit, kontrollojnë dokumentet personale,  
23 shqiptarët nuk qasje në pronën e tyre në anën tjetër të lumit,  
24 KFOR-i nuk është i paanshëm, ata janë vetëm të përqendruar në  
25 pjesën jugore të qytetit, shqiptarët do të manifestojnë, do të

1 demonstrojnë të shtunën në orën 10.00".

2 Pra, ishit në dijeni për situatën në Mitrovicë dhe kur  
3 organizata juaj ka thënë që KFOR-i nuk është i paanshëm?

4 PË. Nuk kam shërbyer në Mitrovicë, z. Avokat.

5 Pra, përgjigja e pyetjes suaj, për aq sa kisha dijeni për  
6 Mitrovicën, ne ishim përqendruar në zonën tonë, do të thoja që  
7 Mitrovica ka qenë e vështirë si kudo tjetër. Por njohuritë e  
8 mia janë të kufizuara dhe sot është e vështirë të përshkruhet  
9 kjo situatë. Unë kam vlerësuar lart raportuesit këtu dhe s'kam  
10 atë dyshim dhe padyshim që atë që kanë thënë ata është e saktë  
11 këtu.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Z. Gjykatës, kërkoj që kjo të  
13 pranohet si provë.

14 Z. BAARLINK: [Përkthim] Nuk jam i sigurtë që dëshmitari  
15 është dëshmitari i duhur për këtë dokument. Njohuritë e tij  
16 për këtë janë të kufizuara.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranoj këtë  
18 provë bazuar në vlerësimin e dëshmitarit lidhur me  
19 raportuesit. Pra, ishte 157, e saktë? Apo 175?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Ishte 175 deri në 178.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, 175 deri  
22 në 178. Ju lutemi jepini një numër këtij.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do jetë prova 1D35.

24 Z. KEHOE: [Përkthim]

25 PY. Pra, kishit informacion se si rezultat, ishit në dijeni



1 [të] Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244, organet  
2 përgjegjëse për qeverisjen e Kosovës ishin Kombet e Bashkuara?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe flasim pak për zbatimin e ligjit.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të nxjerrë në dokument një  
6 dokument nga raporti "Ashtu siç është parë, ashtu si është  
7 treguar" dhe ky do jetë SITF001529, 0001825 dhe më intereson  
8 faqja 1548.

9 PË. Që ta dini, kjo është pjesë, një provë që është nga  
10 Vëllimi 2 i raportit të përmendëm. Në rregull?

11 PË. Po.

12 PY. Ky është dokumenti për të cilin po flisja. Tani ky është  
13 dokument ku paraqitet dislokimi i policisë së UNMIK-ut në  
14 tetor 1999. Siç e shihni numri i personave, i policëve të  
15 ardhur në qershor ka qenë shumë i ulët.

16 PË. Kështu duket.

17 PY. Keni ndonjë arsye që të vinin në pikëpyetje këtë grafik  
18 që del nga ky vëllim?

19 PË. Që t'i biem shkurt, të mos flasim më gjatë për këtë  
20 problem, me shumë bindje ju them që përvoja ime lidhur me --  
21 është që prania e policisë ishte e papërshtatshme për shkak të  
22 organizimit, për shkak të gjendjes së sigurisë katastrofike që  
23 ishte në terren dhe për shkak të numrit të ulët.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Mbrojtja, z. Gjykatës, kërkoi që të  
25 ofrojmë, kërkojmë pranimin si provë të këtij dokumenti

1 SITF001548.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Do të doja që të them lidhur me --  
3 kërkoj ndjesë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë  
5 kundërshtim?

6 Z. BAARLINK: [Përkthim] I njëjti kundërshtim sikurse dhe  
7 më herët, Kryegjykatës. Për mendimin tim për t'u pranuar këto  
8 dokumente dëshmitari duhet të ketë një farë njohurie në lidhje  
9 me to.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokument do  
11 të pranohet si provë materiale.

12 A jeni duke e parashtruar si provë vetëm një faqe të  
13 këtij dokumenti?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, vetëm një faqe.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ti japin një  
16 numër prove.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri i provës që do  
18 t'i jepet është 1D64 për faqen SITF0001548.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë [REDAKTUAR],  
20 [REDAKTUAR].

21 Dëshmitari deshte të vazhdonte me përgjigjen unë e  
22 ndërpreva.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Ishte një situatë e vështirë  
24 sigurie për ta thënë kështu lehtë.

25 Z. KEHOE: [Përkthim]

1 PY. Absolutisht. Dhe UNMIK-u ishte i ngadaltë si të thuash  
2 për t'u krijuar dhe për të filluar të funksiononte në mënyrë  
3 që të parandalonte mungesën e rendit dhe ligjit, a është  
4 kështu?

5 PË. Është një farë vlerësimi ky. Unë mund të kem një mendim  
6 në lidhje me këtë, por ky mendim i imi është i bazuar në  
7 thashetheme dhe në përshtypjen time të përgjithshme nga zona  
8 ku unë punoja. Ashtu ishte. Ishte një mision jo aq i pjekur  
9 sepse ishte në fillesat e veta dhe ishte e vështirë për të  
10 gjithë.

11 PY. Përveç dislokimit të policisë, UNMIK-u gjithashtu ishte i  
12 ngadaltë edhe në krijimin, vendosjen e strukturave qeveritare  
13 apo jo?

14 PË. Unë mund të flas për zonën ku unë isha i vendosur. U desh  
15 pak kohë që të caktohej një administrator. E kam fjalën për  
16 zonën e Rahovecit. Por për të qenë të drejtë duke marrë  
17 parasysh organizimin dhe situatën, rrethanat e anarkisë ishte  
18 mjaft e vështirë, siç e dini, nga aspekti politik dhe praktik  
19 si edhe teknik ishte një mision i vështirë. Ne i kishim të  
20 qarta të gjitha këto vështirësi.

21 PY. Tani po flas për periudhën pas konfliktit, pas  
22 bombardimeve të NATO-s - dhe më korrigjoni nëse e kam gabim -  
23 Hashim Thaçi vazhdimisht ishte brenda komunitetit në media  
24 duke i këshilluar shqiptarët e Kosovës që ta ndërprisnin  
25 dhunën dhe ai e promovonte një Kosovë ndëretnike.

1 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kundërshtoj. Është e pabazë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta  
3 pyesni njëherë në qoftë se ka dijeni dëshmitari për deklaratat  
4 e z. Thaçit në media.

5 Z. KEHOE: [Përkthim]

6 PY. A keni dijeni për deklaratat e z. Thaçi në media duke i  
7 këshilluar njerëzit që të ndërpresin dhunën dhe duke promovuar  
8 Kosovë ndëretnike?

9 PË. Nuk i kam ndjekë deklaratat e z. Thaçi për mediat.

10 PY. Po a ishit në dijeni të faktit se z. Thaçi po e bënte  
11 këtë?

12 PË. Nuk më kujtohet të kem qenë në dijeni të kësaj apo asaj  
13 se ne kishim punën tonë të përditshme.

14 PY. Në raportin tuaj --

15 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe shkurtimisht do t'i kthehem  
16 përmbledhjes së Prokurorisë në vend se të lexoj të gjithë  
17 dokumentin, unë do ta bëj pyetjen për dëshmitarin, mirëpo  
18 pyetja ime del nga ky dokument.

19 PY. Në përmbledhjen e Prokurorisë, ju thoni se:

20 "Rreth nëntorit të vitit 1999, ju", z. Ledwidge, "kishit  
21 dëgjuar nga shumë njerëz që z. Thaçi kishte bërë një fjalim në  
22 një tubim në Rahovec ku kishte deklaruar se koha kur flitet  
23 serbishtja ka përfunduar".

24 A ju kujtohet kjo deklaratë?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, po

1 çfarë ka kjo të bëjë me pyetjen që ia bëtë më përpara  
2 dëshmitarit?

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Pyetja ishte në qoftë se dëshmitari  
4 ishte në dijeni të deklaratave, prononcimeve të z. Thaçi.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po bëni  
6 pyetje konkretisht për një deklaratë që z. Thaçi e kishte bërë  
7 para njerëzve të Kosovës në një tubim në Rahovec.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Do të kërkoj koment nga dëshmitari  
9 në lidhje me këtë.

10 PY. Ju thatë, z. Ledwidge se ju nuk dini asgjë rreth  
11 deklaratave të z. Thaçi.

12 PË. Unë nuk e thashë këtë. Unë thashë që nuk i kam ndjekë  
13 komentet, deklaratat e z. Thaçi në media. Ndoshta më është  
14 raportuar në takimet tona, brifingjet tona me njerëzit nga  
15 media në lidhje me këto deklarata, mirëpo këto deklarata të  
16 politikanëve nuk ishin pjesa kryesore e punës tonë në atë  
17 kohë.

18 PY. Domethënë, nuk ju kujtohen juve këto komente që i ka bë  
19 z. Thaçi në media në Kosovë para popullit të Kosovës, a është  
20 kjo e saktë, kështu e thoni?

21 PË. Po, ashtu e thashë që nuk më kujtohet qoftë kështu apo  
22 ashtu.

23 PY. A ju kujtohet një ngjarje në korrik të vitit 1999, kur z.  
24 Thaçi shkoi në Kosovë, shkoi në Mitrovicë - më falni, në  
25 qershor, jo në korrik - për të qetësuar dhunën që po ndodhte

1 në Mitrovicë?

2 PË. Në atëkohë nuk kam qenë në dijeni. Për të qenë i drejtë,  
3 tani jam në dijeni sepse kam dëgjuar për këtë, kam lexuar për  
4 këtë javën që shkoi në lidhje me këtë incident.

5 Ishte kjo në qershor apo korrik?

6 PY. Do t'ua jap tani datën e saktë të kësaj ngjarjeje të  
7 videos. Data e saktë është -- mund ta luajmë videon në qoftë  
8 se ju kujton diçka. Data është 17 korrik. Dokumenti apo  
9 materiali e ka emrin ERN --

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një pyetje  
11 nga dëshmitari.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Arsyeja pse e kërkova datën, ishte  
13 sepse gjatë qershorit dhe korrikut kishte një krizë në lidhje  
14 me dislokimin e ushtarëve në Rahovec, në qoftë se do të ishin  
15 rusë apo holandezë. Mendoj që ky incident ndodhi rreth asaj  
16 kohe. Situata ishte e tendosur dhe ndoshta nuk e kam ndëgjuar  
17 fjalimin e z. Thaçi atëherë, por jam në dijeni, më është vënë  
18 në dijeni gjatë dy javëve t fundit. Përveç kësaj që ju thashë  
19 nuk kam ndonjë gjë tjetër për t'ju komentuar.

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Do ta kundërshtoj këtë, i nderuar  
21 Gjykatës. Fakti që dëshmitari ka lexuar për këtë javën e  
22 kaluar nuk është bazë e mjaftueshme për këtë pyetje nga  
23 Mbrojtja.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranoj  
25 kundërshtimin. Dëshmitari tha që nuk di gjë për këtë, se kam

1 kuptuar fjalim një javë më parë, kështu që nuk ka nevojë që të  
2 futemi në këtë temë.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, në çfarë rrethanash mësuat për këtë javën që  
5 shkoi?

6 PË. Mendoj që po lexoja diçka në lidhje me incidentin në  
7 lokalit Panda. Po kërkoja një raport të medias në lidhje me  
8 Rahovecin dhe aty diçka lexova në lidhje me këtë. Po me të  
9 vërtetë nuk e di. Kam bërë disa kërkime dokumentesh javën që  
10 shkoi, sepse unë ashtu e kam natyrën, dua të bëj kërkime. Dhe  
11 gjatë atyre kërkimeve doli kjo deklaratë, prononcim i z.  
12 Thaçi.

13 PY. Dhe deklarata për të cilën po flisni ju thoni që Thaçi ka  
14 dhënë një deklaratë, një tubim në Rahovec ku ka thënë se "ka  
15 përfunduar koha e serbishtes këtu"?

16 PË. Kjo është në bazë të kujtesës sime dhe, me sa më  
17 kujtohet, kjo ka ndodhë rreth festës së flamurit dikund në  
18 nëntor, është diku nga fundi i nëntorit është dita e flamurit  
19 dhe rreth saj date.

20 Rreth asaj kohe kishte një farë ndjeshmëri, cënueshmëri,  
21 ndishmëri. Dhe kjo më kujtohet shumë qartë. Dhe ne, ekipi im i  
22 vogël, e çmuam si të pasigurte që të udhëtonim nga Prizreni në  
23 Rahovec. Në qoftë se më kujtohet drejt.

24 Për atë arsye përmbajtja e atij fjalimi, ashtu siç ju po  
25 i thoni, më është thënë, më është përcjellë nga stafi. Unë

1 vetë nuk kam qenë aty dhe atë që e kam thënë e kam thënë në

2 bazë të asaj që kam dëgjuar.

3 PY. Atëherë nuk keni lexuar asnjë gjë për këtë dhe në mediat  
4 serbe?

5 PË. Nuk lexoj mediat serbe.

6 PY. Po a ju kanë treguar në qoftë se ka pasë diçka në lidhje  
7 me këtë fjalim të z. Thaçi në mediat serbe?

8 PË. Jo, me sa kujtohet.

9 PY. Tani në bazë të përvojës që keni ju keni punuar me serbët  
10 për të gjetur njerëzit e zhdukur dhe a jeni në njohuri të  
11 propagandës që është përdorë materialit propagandues?

12 PË. Jam në dijeni që qeveria serbe ka përdorë pretekste,  
13 kishte përdorë pretekste një vit më parë se komuniteti, si të  
14 thuash, ishte i thyer për shumë arsye dhe njëra prej tyre  
15 ishte edhe mungesa e 40 të afërmeve të tyre.

16 PY. Po a ju kujtohet që në mediat serbe të jetë përcjellë kjo  
17 deklaratë e z. Thaçi që në Kosovë ka përfundu koha kur flitet  
18 serbishtja?

19 PË. Unë, siç ju thashë, nuk më kujtohet të më jetë raportuar  
20 një gjë e tillë.

21 PY. Po lexoni ju mediat serbe apo artikujt në mediat?

22 PË. Nuk më kujtohet, unë siç thashë, nuk kam qenë aty dhe nuk  
23 mund t'ju ndihmoj më tej më tej me këtë përgjigje.

24 PY. Atëherë nuk keni arsye për të kundërshtuar që asnjë nga  
25 këto burime të mediave nuk ka reportu që një deklaratë e tillë



1 është bërë nga z. Thaçi, a është kjo e saktë?

2 PË. A mund të përsërisni pyetjen se nuk ju kuptova.

3 PY. Unë ua bëra të qartë që në atë kohë nuk kam lexu mediat.

4 Nuk kemi pasur internet siç kemi tani. Nuk më kujtohet të kem

5 lexuar për këtë deklaratë dhe nuk di në qoftë se ka ndodhur në

6 të vërtetë se nuk kam qenë vetë aty. Thashë që kam dëgjuar për

7 këtë ndoshta kam lexuar ndonjë raport apo ndonjë procesverbal

8 në lidhje me këtë dhe nuk mund të komentoj më shumë se kaq.

9 PY. Ju mund të thoni që nuk keni lexuar asnjë media, asnjë

10 koment, asnjë artikull, ku të reflektohet një koment i tillë i

11 z. Thaçi?

12 PË. Puna ime ishte që të gjeja njerëzit e zhdukur dhe të

13 trajtoja çështjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

14 Mendoj, për t'ju përgjigjur pyetjes tënde mendoj që nuk kam

15 dëgjuar. Në atëkohë ishte posaçërisht e vështirë për ata që

16 nuk ishin shqiptarë të dalin në rrugë të Prizrenit dhe për

17 këtë edhe në Rahovec dhe, siç thashë, ishte dikund rreth ditës

18 së flamurit apo në ditën e flamurit, mund edhe të mos ketë

19 qenë në atë ditë, po kështu më kujtohet.

20 Mund të jetë bë edhe në ndonjë datë tjetër, po sido që të

21 jetë unë vetë nuk kam qenë i pranishëm kur është bë ajo

22 deklaratë.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Vetëm një sekondë, të nderuar

24 Gjykatës, të konsultohem.

25 [Mbrojtja këshillohet]

1 Z. KEHOE: [Përkthim]

2 PY. Një pyetje të fundit apo një grup të fundi pyetjesh.

3 Detyra juaj si oficer i OSBE-së për të raportuar lart se  
4 kryeministri i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ka thënë  
5 sikurse pretendohet se "koha e të folurit serbisht në Rahovec  
6 ka përfunduar". A nuk ishte kjo një detyrë që ju të raportoni  
7 një të tillë?

8 PË. Është e mundur që ta kem raportuar, në qoftë se e kam  
9 çmuar se është e vlefshme për t'u raportuar.

10 PY. Po keni ndonjë raport apo gjatë diskutimeve me ZPS-në, ju  
11 keni raportuar që kryeministri i Qeverisë së Përkohshme të  
12 Kosovës ka bërë një deklaratë të tillë në Rahovec?

13 PË. A kam parë një raport të tillë kohëve të fundit?  
14 Kjo është pyetja juaj? Jo, nuk kam parë.

15 PY. Po a keni parë përgjithësisht ndonjë raport të OSBE-së ku  
16 të përmendet se z. Thaçi ka bërë një deklaratë të tillë apo a  
17 keni parë vizualisht në ndonjë prej mediave, qoftë me të  
18 shtypura apo vizuale, që të jetë raportuar se z. Thaçi ka  
19 deklaruar një gjë të tillë?

20 PË. Unë e kam përsëritur përgjigjen disa herë tani. Kjo më  
21 është raportuar dhe mund ta thjeshtojmë fare përgjigjen mund  
22 të them që ajo është e bazuar në thashetheme, në gjëra që kam  
23 dëgjuar.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitar, nuk  
25 kam pyetje të tjera.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Strong.

2 Z. STRONG: [Përkthim] Faleminderit.

3 Pyetje të palës tjetër nga Z. Strong:

4 Z. STRONG: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, unë jam Andrew Strong dhe do t'ju bëj pyetje  
6 në emër të Mbrojtjes së z. Kadri Veseli.

7 Nuk kam shumë pyetje për ju, po do të filloj medias  
8 pyetje konkrete për kontekstin në të cilin filluat punën në  
9 Kosovë.

10 Së pari, ju mbërritët në Kosovë në mes të nëntorit 1998,  
11 a është e saktë kjo?

12 PË. Po. Përafërsisht pak mbas asaj pyetje.

13 PY. Dhe data që kam unë kur jeni dislokuar në Prizren është  
14 më 18 nëntor? Është kjo e saktë?

15 PË. Jo, është pak më pas. Kam pasë fluturimin më datën 18,  
16 pastaj kam qenë në Beograd disa ditë dhe disa ditë më pas kam  
17 udhëtuar për në Prishtinë dhe më pas në Prizren. Për të qenë  
18 më të saktë. Dhe për hir të tërësisë së kontekstit, do të them  
19 që më kujtohet, se kam arritur në selinë tonë atje në Kosovë  
20 më datën 25 ose 26 nëntor.

21 PY. Ju na thatë ju raportuan shkurtimisht në lidhje me atë që  
22 po ndodhte në terren në atë kohë?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe gjithashtu do të kisha të drejtë të them se ju po  
25 dislokohehit në një zonë ku po zhvilloheshin luftime aktive?

1 PË. Po, dislokoheshim në një zonë të tillë me qëllimin e një  
2 misioni për armëpushim.

3 PY. Dje dhe kjo është në faqen e transkriptit 29 të djeshëm,  
4 ju thatë që ishte një periudhë mjaft kaotike dhe që po kishte  
5 vrasje nga të dy palët?

6 PË. Po, ashtu thashë.

7 PY. Dhe në kontekstin e ardhjes suaj në një ambient të tillë  
8 kompetencat tuaja ishin që mblidhnit informacion për të  
9 përcaktuar fatin e personave të zhdukur. A është kjo e saktë?

10 PË. Jo, nuk është ashtu. Më lejoni të sqaroj.

11 Ishim 20 në ekip. Unë fillimisht isha një oficer i  
12 operativës, detyra ime kryesore ishte që t'i pajisja njerëzit  
13 me radiolidhje, t'i drejtoja ekipet të marrë raporte për  
14 incidente, t'i raportoja ato incidente larg zinxhirit  
15 komandues të misionit verifikues të Kosovës dhe të merrja dhe  
16 zbatoja udhëzimet e shefit tonë Ian Macleod dhe zëvendësit të  
17 tij. Ishim një ekip i vogël. Ajo që ndodhte rreth nesh ishte  
18 shumë, domethënë, ishin në një zonë mjaft aktive dhe siç  
19 thashë dje kjo po ndodhte gjatë verës.

20 PY. Ju keni thënë vazhdimisht se nuk kishit kohë që të  
21 shihnit se çfarë kishte ndodhë përpara për shkak të dinamikës,  
22 situatës në kohën kur ju u dislokuat aty?

23 PË. Për ta ritheksuar përgjigjen e djeshme timen, z. Strong,  
24 do t'ju them kështu, me gjithë respektin që kam për pozitën  
25 dhe mendimin e kolegëve tuaj, 17 avokatë në një dhomë dhe

1 stafi mbështetës për herë të parë me ndihmën e një organizimi  
2 që po përfaqëson interesat e veta në mbrapsht në histori është  
3 diçka e kontestueshme. Ne në atë kohë nuk kishim ato burime që  
4 janë të disponueshme sot për të studiuar strukturat komanduese  
5 apo incidentet e kontestueshme historike. Ne ishim të  
6 përqendruar me atë se çfarë po ndodhte dita ditës aty në  
7 terren.

8 PY. Faleminderit përgjigjen. Ajo që më intereson mua dhe kjo  
9 bazohet në përgjigjen që dhatë ju. Roli juaj si një hetues i  
10 të drejtave të njeriut kur keni shkuar aty, se me sa kuptova  
11 nga përgjigja juaj, erdhi një moment kur filluat të bënit dhe  
12 vetë hetime dhe si veçanërisht për ngjarjet që ndodhë në  
13 korrik të 1998?

14 PË. Më emëruan si oficer përgjegjës për personat e zhdukur me  
15 sa më kujtohet dikund në janar, fund janarit të 1999. Mirëpo  
16 parimi ishte i njëjtë kishim përballë një organizim që na  
17 mbante të verbër, ne nuk dinim asnjë gjë se çfarë po ndodhte.  
18 Eprorët e lartë të UÇK-së ishin fushë e përgjegjësisë së një  
19 ekipi tjetër.

20 Puna ime, ashtu siç e shikoja unë, ishte e kufizuar dhe  
21 bazohej në udhëzimet që i merrja nga ekipi drejtues në  
22 Prishtinë dhe ky mision ishte që të përcaktohet vendndodhja e  
23 47 personave të zhdukur që ishin serbë, romë dhe shqiptarë.

24 Domethënë, këto janë dy detyra të ndryshme. Ne i kryenim  
25 aq sa mundeshim me të mirën tonë. Unë kisha shumë pak ndihmës.

1 Dikund nga marsi u caktua dhe një persona tjetër si ndihmës i  
2 imi për këtë detyrë, domethënë, detyra parësore e jonë ishte  
3 që të përcaktonim fatin e 47 personave të zhdukur në kontekst  
4 të këtyre procedurave këtu.

5 PY. Faleminderit. Ju lutem e shoh që pak i zgjeruat  
6 përgjigjet, të jeni sa më i përpiktë në përgjigjet e juaja dhe  
7 t'i mbani më të shkurtra.

8 PË. Në rregull. Do të përpiqem.

9 PY. Më falni, që po ju ndërpres.

10 PË. Po vetëm më lejoni të sqaroj. Ne filluam faktikisht t'i  
11 kërkonim të bënim kërkim fizik të disa zonave të cilat kishim  
12 marrë informacion në lidhje me atë që thashë më përpara.

13 PY. Do t'ju ndërpres këtu. Ju lutem të keni parasysh pyetjet  
14 që ua bëj. Në qoftë se doni diçka të shtoni Prokuroria do t'ju  
15 bëjë pyetje plotësuese dhe këtë mund ta bëni më pas.

16 PË. Në rregull.

17 PY. Mua më interesojnë sfidat me të cilat u përballët në atë  
18 kohë në lidhje me ngjarjet në korrik të 1998. Dhe do t'i ndaj  
19 pyetjet e mia në tre fusha të ndryshme që dua t'i kaloj bashkë  
20 me ju.

21 E para.

22 Z. STRONG: [Përkthim] Kërkoj nga Sekretarja që të vendosi  
23 në ekran dokumentin SPOE00196138.

24 PY. Dëshmitar, e keni të njohur këtë dokument?

25 PË. Po.

1 PY. Në krye thotë, Misioni Verifikues i Kosovës Qendra për  
2 Koordinim 1.

3 A ishte kjo qendra e koordinimit ku keni punu ju?

4 PË. Po.

5 PY. Shkëlqyeshëm.

6 Z. STRONG: [Përkthim] Tani të shkojmë në fund të faqes.  
7 Krejtësisht në fund të faqes.

8 PY. Aty mesa duket përpiluesi i këtij dokumenti është Ian  
9 Macleod?

10 PË. Po. Kjo ka qenë pjesë e procedurave që kemi ndjekur.  
11 Është shënuar emri i shefit apo drejtuesit, por mund të them  
12 që Ian ka luajtur një farë roli sepse i gjithë ekipi jonë, në  
13 qoftë se mund ta quaj ashtu, ishte i përfshirë në këto hetime.

14 PY. E kuptoj.

15 Z. STRONG: [Përkthim] Tani të vendosim në ekran  
16 dokumentin SPOE00196141.

17 PY. Aty tek pjesa "në lidhje me raportimin" ne shohim që:

18 "RC1 ka bërë kontakt, ka vendosë kontakt me familjarët e  
19 personave të zhdukur dhe është në marrëdhënie të mira me ta.  
20 Ata janë të pranishëm rregullisht në qendrën e koordinimit në  
21 Rahovec. Dhe e përcjellin informacionin që e kanë marrë nga  
22 shqiptarët e vendit. Një pjesë e këtij informacioni vjen në  
23 këtë mënyrë.

24 "Rreziku i marrjes së informacionit joburimor në këtë  
25 mënyrë qëndron një raport riqarkullohet. Dhe pastaj

1 përmirësohet. Dhe pjesa më e madhe e këtij informacioni vjen  
2 në këtë mënyrë”.

3 Ju jeni autor i këtij dokumenti, çfarë mund të na thoni  
4 në lidhje me të?

5 PË. Më kujtohet që e kam hartuar një pjesë të këtij dokumenti  
6 në qoftë se jo të tërë dokumentin.

7 PY. Ky ishte një problem që ju e dinit, duheshit të ishit  
8 vigjilent për ta bërë ndarjen midis asaj që ishte informacion  
9 i ri dhe një informacioni që ishte i një natyre riqarkulluese  
10 që përsëritej dhe që mund të ndryshonte?

11 PË. Ky ishte një problem i posaçëm dhe, siç e thashë më  
12 përpara, domethënë, ishte diçka e cila shikohej në rrugët e  
13 Rahovecit dhe të Prizrenit ku njerëzit shiheshin ose  
14 pretendoheshin të ishin parë në rimorkiot e veturave ose të  
15 automjeteve të tjera e kështu me radhë.

16 PY. Personat që mblidheshin ose takoheshin rregullisht, këto  
17 ishin të afërmit e viktimave që ju kërkoni apo jo?

18 PË. Po. Ishin nënat, motrat, vëllezërit.

19 PY. Dhe ju e njihnit shumë mirë njeri-tjetrin, kështu i  
20 takon?

21 PË. Disa prej tyre e njihnin njeri-tjetrin shumë mirë, disa  
22 të tjerë më pak. Disa ishin nga fshatrat dhe nga qyteza.

23 Qyteza ishte në afërsi të Rahovecit, në Graçanik dhe secili  
24 prej fshatrave kishte disa qindra banorë. Ndoshta qyteza  
25 kishte disa mijëra banorë. Për këtë situata ishte e tillë që



1 ata që jetonin në fshatra e njihnin mirë njeri-tjetrin, në  
2 veçanti ata që ishin shqiptarë të Kosovës. Mund të them që  
3 është një qytet i vogël, megjithatë, nuk mund të them që të  
4 gjithë e njihnin njeri-tjetrin. Ndërkohë që për ata që vinin  
5 nga fshati ata e njihnin më mirë njeri-tjetrin.

6 PY. Por ata që vinin, domethënë, nga zona më të vogla rurale  
7 i takon që e njihnin më mirë njeri-tjetrin?

8 PË. Po.

9 PY. Përderisa informacioni që ju jepnin juve ishte shumë i  
10 ngarkuar emocionalisht, njerëzit dëshironin të besonin që këto  
11 thashetheme që dëgjonin, pra, ishin pak a shumë në formë  
12 rrethore në kuptimin që qarkullonin nga njeri tek tjetri?

13 PË. Ata dëshironin që të besonin që të afërmit e tyre ishin  
14 të gjallë ende dhe nuk ishin të hedhur në ndonjë kanal diku.

15 PY. A ju kujtohet se kur kanë filluar këto takimet e  
16 rregullta?

17 PË. Shkurtimisht, në qoftë se më lejoni, z. Strong, më lejoni  
18 të them që këto janë takime të cilat kanë filluar menjëherë  
19 pasi kemi mbërritur ne atje.

20 PËRKTHYESI: [Përkthim] Ju lutem flisni më ngadalë.

21 Z. STRONG: [Përkthim] Patjetër.

22 Le të shohim një tjetër dokument, që është deklarata që i  
23 keni dhënë ZPS-së. Për identifikim është prova materiale P230.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të them diçka, të nderuar  
25 Gjykatës?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, patjetër.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Ka ende njerëz që edhe sot e kësaj  
3 dite besojnë që të afërmit e tyre janë gjallë.

4 Z. STRONG: [Përkthim] A mund të shohim paragrafin 25, ju  
5 lutem?

6 PY. Dëshiroj ta shihni këtë paragraf.

7 Z. STRONG: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë e kam dhënë numrin  
8 gabim të paragrafit. Është paragrafi me numër 22. Ju kërkoj  
9 ndjesë, znj. Sekretare.

10 PY. Në të thuhet:

11 "Në lidhje me deklaratën që ishte në interesin e  
12 nënkuptuar të autoriteteve serbe për këta persona që qëndronin  
13 të zhdukur dhe për çështjet e hapura që të mos zgjidheshin,  
14 kjo u bazua në faktin se serbët po përpiqeshin të përdornin  
15 rastin e të zhdukurve që të nxisnin mbështetjen e serbëve të  
16 Kosovës për të inkurajuar një farë ndjesie viktimizimi. Besoj  
17 se telefonatat që morën familjet e viktimave ishin pjesë e  
18 kësaj përpjekjeje të bërë nga provokuesit serbë. Në  
19 televizionin serb shfaqen rregullisht pjesë të cilat ishin  
20 krijuar qartazi për të stimuluar emocione dhe keqardhje për  
21 familjet e personave të zhdukur për arsye politike".

22 Dua t'ju pyes për sa i takon fjalisë së parafundit në  
23 këtë paragraf, që kishte telefonata që merrnin familjet e  
24 viktimave dhe këto ishin pjesë e kësaj përpjekjeje të bërë nga  
25 provokuesit serbë. A mund të na shpjegoni se çfarë do të thotë

1 kjo?

2 PË. Po. Disa nga të afërmit merrnin telefonata që pretendohej  
3 që të bëheshin nga të afërmit e tyre ose persona që i kishin  
4 parë familjarët e tyre. Pra, në rrethanat që kanë ndodhur  
5 këto, personat ose, A, kishin vdekur ose, B, ne mendonim që do  
6 të ishin telefonata ose thirrje jo reale, jo të qenësishme.  
7 Nuk jam i sigurtë se nga vinin këto thirrje. Nuk do çuditesha  
8 që këto thirrje të mund të vinin nga serbët, nga instanca të  
9 caktuara serbe.

10 Unë jam informuar, siç besoj e keni lexuar dhe në  
11 deklarata, që nga një oficer zbulimi serb nga koloneli Milan  
12 Petrovic nga autoritet serb dhe për ta zgjeruar më tej për atë  
13 çfarë thuhet ose çfarë përshkruhet në këtë paragraf, më lejoni  
14 të them, që ne jemi, ishim plotësisht të vetëdijshëm se cili  
15 ishte fati i atyre personave. Kishim një lloj ndjesie se çfarë  
16 fati kishin këta persona. Megjithatë as UÇK-ja nuk thoshte  
17 asgjë për ta dhe as serbët nuk thonin gjë të.

18 Z. STRONG: [Përkthim] Ky paragraf që sapo lexova  
19 shoqërohet me një seksion qartësues në deklaratën e TPNJ-së  
20 dhe në provën materiale 232, në faqen 13, pra, që titullohet  
21 "Qëndrimi i autoriteteve serbe".

22 PY. Z. Ledwidge, aty ju flisni për telefonata të cilat vinin  
23 nga Kukësi ose nga Bosnja dhe që e rrisnin në mënyrë të  
24 natyrshme, do thoja unë, ndjeshmërinë e viktimave, kështu?

25 PË. Po, të nderuar Gjykatës. Besoj që ju jeni në dijeni të

1 njëjtës dinamike që ka ndodhur në Bosnje. Për shembull, kur  
2 kam qenë Bosnje kam takuar me të ve, me persona, me gra të  
3 veja nga Srebrenica të cilat ishin pothuajse në të njëjtat  
4 rrethana dh pothuajse ishte e njëjta situatë.

5 PY. Pra, a është e drejtë të thuhet që sa i takon theksimit  
6 të sfidave të informacionit të marrë, a mund të thuhet që  
7 raportet e MVK-së kishin një natyrë të tillë që informacioni  
8 qarkullonte dhe raportet, pra, transferoheshin nga një person  
9 tek tjetri dhe shtoj përveç informacionit që merrshin nga  
10 palë të tjera shtoj dhe informacioni i ri? A është e drejtë  
11 kjo që të thuhet?

12 PË. Nuk mendoj që nuk është e drejtë dhe për këtë arsye ne  
13 morëm deklaratat e të afërmeve të tyre mbështetur në fakte ose  
14 gjëra që ata i mendonin si fakte dhe duke u mbështetur  
15 gjithashtu në përvojat e tyre personale.

16 PY. Në fjalinë e fundit që ka të bëjë me programet televizive  
17 serbe që ishin krijuar qartazi për të stimuluar emocionet dhe  
18 keqardhje. A i keni parë këto programe vetë?

19 PË. Po. Në shtëpinë që jetonim ne kishte një televizion.  
20 Kishte një televizion për përdorimin tonë dhe ishte,  
21 domethënë, kishim kanalin e Euronews, kishim gjithashtu edhe  
22 televizionin ose kanalin serb. Kështu që kishte pjesë në  
23 programin e televizionit dhe që kishte si synim që të nxiste  
24 emocionet, përmbante citime, klipe nga të afërm, deklaratat  
25 intervista, kamera. Nuk më kujtohet që ndonjëri nga Rahoveci

1 të ishte i pasqyruar në ato video, sepse, besoj që e dini, që  
2 bëhej fjalë për disa qindra persona të zhdukur të marrë nga  
3 UÇK-ja në të gjithë zonën.

4 Megjithatë, unë nuk mbaj mend që të ketë pasur persona  
5 nga Rahoveci të jenë përfshirë në atë operacion të veçantë.  
6 Por sigurisht që ata ishin viktima të këtij operacioni.

7 PY. Domethënë, përgjigja juaj është që ju i keni parë këto  
8 programe televizive vetë?

9 PË. Po, i kam parë një ose dy herë, por po i kam parë vetë  
10 këto programe.

11 PY. Më lejoni të kaloj në temën e fundit për të cilën do t'ju  
12 bëj pyetje dhe të cilën ju e cekët dje me z. Kehoe. Përveç dy  
13 sfidave të para që kishin të bënin me mbledhjen e  
14 informacionit për periudhën që keni qëndruar në Kosovë, ju i  
15 thatë si më poshtë z. Kehoe, kjo për procesverbal jepet në  
16 faqen 70. Pyetja që ju bëri z. Kehoe ishte, pra:

17 "Ju e dinit që ata po i torturonin njerëzit për t'ju  
18 marrë atyre informacion?"

19 Dhe kur thotë "ata" e ka fjalën, besoj, për autoritetet  
20 serbe? Përgjigje:

21 "Po, absolutisht, po. Ata sigurisht që po e bënin këtë,  
22 domethënë, po torturonin të burgosurit e UÇK-së për  
23 informacion për të burgosurit serbë, për personat e kidnapuar  
24 apo të zhdukur".

25 Ky ishte konteksti i deklaratës tuaj, deklaratës që ju i

1 keni dhënë ZPS-së. Dhe ju thoni:

2 "Po, po ishte një gjendje torturuese, po".

3 Pyetja ime është kjo: Kjo është një tjetër shtesë sfide  
4 ose vështirësie që ju kishit sa i takon mbledhjes së  
5 informacionit të saktë. Së bashku me informacionin e pasaktë  
6 që ju jepnin në familjarët dhe natyrës së qarkullimit të  
7 fjalëve ndërmjet këtyre grupit të njerëzve, domethënë, ju  
8 ishit të rrezikuar që një pjesë e informacionit që qarkullonte  
9 në atë zonë mund të ishte informacion që ishte nxjerrë përmes  
10 torturës, a është kështu?

11 PË. Nuk e kuptoj shumë mirë pyetjen sepse ishte një deklaratë  
12 për shumë gjëra, kështu që nuk e di në qoftë se mund të ma  
13 sqarosh pak.

14 PY. Po, po. Mund ta shpreh ndryshe pa problem. Pyetja që kam  
15 për ju është kjo: Ty të duhej që të ishe gjallë në kuptimin që  
16 ju keni qenë në një situatë të tillë që duke marrë parasysh  
17 natyrën e informacionit që qarkullonte dhe informacionit që u  
18 vinte juve besoj që është e drejtë të thuhet që një pjesë e  
19 këtij informacioni vinte si rezultat i torturës?

20 PË. Së pari, është ironi e vërtetë që tortura që përmenda dje  
21 nga forcat serbe është zhvilluar ose ka ndodhur në të njëjtin  
22 vend që sipas të afërmeve UÇK-ja, pra, torturonte të ndaluarit  
23 e tjerë që ishin në stacionin e policisë së Malishevës.

24 Dhe për t'ju përgjigjur pyetjes, më lejoni të them, që  
25 asnjë prej personave me të cilët unë kam folur, kam

1 bashkëbiseduar nuk janë torturuar, domethënë, bashkëbiseduesit  
2 serbë nuk janë torturuar. Ata ishin absolutisht të gatshëm.  
3 PY. Nuk e sugjeroj fare këtë. Nuk ishte kjo ajo çka po thoja.  
4 Por sugjerimi ose parashtrimi im është që, si hetues, situata  
5 ishte e tillë që ju po futeshit në një zonë ose një mjedis  
6 informacioni ku nuk keni qenë personalisht, domethënë dhe  
7 informacioni që qarkullonte vinte, besoj e dini këtë gjë,  
8 vinte nga burime të ndryshme dhe njëri prej burimeve të  
9 informacionit ishte, mund të ndodhte, për shembull, që  
10 informacioni që juve ju është dhënë të ishte mbledhur përmes  
11 torturës.

12 Dhe pyetja që kam për juve është që a ishit të informuar  
13 për rrezikun?

14 PË. Po.

15 PY. Faleminderit.

16 PË. Ju lutem, më lejoni që të përfundoj. Më lejoni të them që  
17 pjesë e qeverisë serbe ishte mekanizmi i qeverisë për të  
18 përdorur masa të tilla. Megjithatë më lejoni të them dhe  
19 njëherë tjetër që të gjithë bashkëbiseduesit e mi serbë nuk  
20 ishin pjesë e kësaj torture. Dhe nuk jam në gjendje të flas  
21 lidhur me këtë sepse, siç e thashë dhe në fillim fare,  
22 personeli i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë refuzonte të jepte  
23 përgjigje për pyetjet tona, pra, ishte tërësisht i heshtur.

24 Sa i takon çështjes së torturës ose mbase trajtimi i  
25 pikës në mënyrë më të --i kësaj çështjeje në mënyrë më direkte

1 besoj që është e drejtë të thuhet që diskutimet me kolonel  
2 Petrovicin, i kishte përdorur informacione të tilla,  
3 megjithatë, unë nuk është se kam ndonjë informacion të  
4 drejtpërdrejtë që më thotë që personat me të cilët unë kam  
5 folur kanë subjekt torture ose kanë pësuar torturë.  
6 PY. Faleminderit. Nuk pyetje të tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully,  
8 juve thatë që keni rreth 20 pyetje apo jo?

9 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
10 pyetje. Sepse u bënë pyetjet që ne planifikonim që të bënim.  
11 Kështu që ju lajmëroj që nuk kemi pyetje të tjera.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis,  
13 përderisa ju keni nevojë për më shumë kohë i takon që, ndoshta  
14 do të jetë më mirë që të bëjmë pushimin tani dhe pastaj të  
15 kthehemi përsëri dhe të mbarojmë pjesën tuaj të pyetjeve.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj që do ishte më mirë kështu.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
18 Do të bëjmë pushimin tani. Do bëjmë pushim deri në orën 11.15  
19 ose ndoshta 11.20.

20 E mbyllim këtu seancën e paradites. Mund ta nxirrni  
21 dëshmitarin nga salla e gjyqit, Sekretare e Seancës.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 --- Pauza fillon në orën 10.46

24 --- Seanca rifillon në orën 11.20

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.



1 Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, a  
4 më dëgjoni?

5 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, shumë mirë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do t'ju  
7 marrë në pyetje z. Ellis nga Mbrojtja e z. Krasniqi.

8 Z. Ellis, e keni ju fjalën.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

10 Pyetje të pala tjetër nga z. Ellis:

11 Z. ELLIS: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

13 PË. Mirëmëngjes.

14 PY. Do të përpiqem që të përfundojmë me kundërpvetjet tona  
15 përpara pushimit të drekës, por në mënyrë që kemi mundësi që  
16 ta bëjmë këtë gjë na duhet që të kalojmë pak si shpejtë në  
17 seksionet e para. Kështu që dëshiroj që përgjigjet që lidhen  
18 me materialet për të cilat keni dhënë dëshmi më herët do të  
19 doja që t'i kalonim shpejtë. A më kuptoni për çfarë e kam  
20 fjalën?

21 PË. Po, do të varet nga pyetjet që do të më bëni.

22 PY. Qëllimi i punës tuaj në Rahovec ishte që të përcaktonit  
23 fatin e personave të zhdukur?

24 PË. Po, një prej synimeve.

25 PY. Ju nuk e keni konsideruar veten si hetues penal, apo jo?

1 PË. Nuk kam qenë aty në atë kapacitet. Kështu që përgjigjja  
2 në pyetjen tuaj do të ishte do ishte jo.

3 PY. Në këtë periudhë në fund të 1998, Christopher Cobb-Smith  
4 ishte një prej oficerëve ndërlidhës që punonte me juve në  
5 zonën e Rahavecit, apo jo?

6 PË. Po, e njoh Chris.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Ju lutem a mund të paraqisni në  
8 ekran dokumentin 075959 deri në 075992. Kërkoj që të shfaqet  
9 ose të paraqitet në ekran faqja 75969, paragrafi 40, ju lutem

10 PY. Kjo është një deklaratë e mëhershme e z. Cobb-Smith.

11 Do ju kërkoja që të lexonit paragrafin 14.

12 PË. E lexova.

13 PY. Përpara sesa të pija unë një gllënjë ujë.

14 PY. Po.

15 PY. Pra, ju në këtë paragraf identifikoheni si personi më  
16 shumë i përfshirë për këtë çështje?

17 PË. Po, kështu ishte.

18 PY. Po ju keni konfirmuar që nuk keni pasur kohë që të  
19 përfshiheshit në aktivitetet hetimore dhe nuk ju është kërkuar  
20 nga zinxhiri i komandës që të përfshiheshit.

21 PË. Ai flet për rolin e këtu. Nuk është e saktë kjo. Ai po  
22 flet këtu për rolin e vetë. Dhe në qoftë se keni pyetje të  
23 tjera ndoshta do të duhet që të bëni atë, sigurisht që ishte  
24 ai ishte dhe Andy Lefever, që ishte një oficer tjetër  
25 ndërlidhës për UÇK-në.

1 PY. Ajo çfarë thatë dje dhe, besoj që e thatë edhe sot, e  
2 përsëritët edhe sot për z. Smith që ju nuk kishit mundësi që  
3 të trajtonit përtej asaj çfarë ju paraqitej për momentin?

4 PË. Unë thashë që nuk kisha mundësi në masën që më pyeti,  
5 domethënë, për pyetjen që më bëri z. Kehoe. Kjo është e  
6 vërtetë.

7 PY. Besoj se na e konfirmuat, sot paradite, që nuk ishte  
8 pjesë e synimeve tuaja që të gërmonit në strukturat e komandës  
9 së UÇK-së nga korriku i 1998. Kështu apo jo? Këto janë fjalët  
10 tuaja.

11 PË. Edhe po të ishte, nuk kisha kontakte për të zbuluar më  
12 shumë informacion sa i takon organizimit që ishte kryer

13 PY. Ju s'ishit personi brenda OSBE-së që kishit detyrën që të  
14 kontaktoni me UÇK-në, kështu?

15 PË. Po, kjo është. Andy Strong edhe Chris Cobb-Smith ishin  
16 atje gjithashtu.

17 PY. Juve u pyetët për strukturat ushtarake në Rahovec dhe  
18 përgjigja juaj ishte që nuk ishte pjesë e detyrave tuaja që të  
19 dinit se cilat janë këto struktura?

20 PË. Mund t'i jem përgjigjur kësaj pyetjeje. Mendoj që kjo  
21 reflekton të vërtetën deri në masën që është relevante dhe ne  
22 kishim mundësi që ta bënim një gjë të tillë. Megjithatë, ishte  
23 shumë e vështirë që të penetroje apo të depërtoje në një  
24 organizatë të tillë kaq opake dhe ishte shumë e vështirë të  
25 kontaktonim me një organizatë të tillë që nuk kishin asnjë

1 pikë vullneti për të dhënë informacion për të zhdukurit dhe më  
2 pas edhe për të vrarit.

3 PY. Pra, i takon që ju nuk keni asnjë informacion për  
4 Malishevën rreth asaj periudhe, apo jo?

5 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kundërshtojmë. Është çështje  
6 themelësie, të nderuar Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i  
8 përgjigjeni. Rrëzohet kundërshtimi.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Më thoni edhe një herë pyetjen.

10 Z. ELLIS: [Përkthim]

11 PY. Nuk e keni ditur se cila ka qenë komanda ose cila ka qenë  
12 struktura e UÇK-së në Malishevë në korrik 1999?

13 PË. Nuk më kujtohet.

14 PY. Dhe nuk e konsideronit që ishte pjesë e detyrave tuaja që  
15 të kuptonit më mirë lidershipin ose të merrnit vesh se kush  
16 ishte lidershipi i UÇK-së?

17 PË. Do ta kisha kuptuar që ishte pjesë e përgjegjësive të mia  
18 ose fushës time po të kisha kohën dhe po të kisha burimet. E  
19 thashë edhe më herët, që jo vetëm kaq, por edhe nuk kishte  
20 gatishmëri ose vullnet nga bashkëbiseduesit e UÇK-së, siç e  
21 thotë e Chris në këtë paragraf, që të jepnin informacion.  
22 Domethënë, me fjalë të tjera, ekipi i ndërlidhjes së UÇK-së  
23 nuk është se të jepte shumë informacion atëherë.

24 PY. Nuk është kritikë për ju, z. Dëshmitar.

25 PË. Jo, nuk po e marrë ashtu.

1 PY. Po them që ju po operonit në një mjedis shumë të

2 vështirë. A kishte arsye për këtë?

3 PË. Siç e thashë nuk e marrë si kritikë personale. Po

4 përpiqem që t'i përgjigjem pyetjes tuaj.

5 PY. Ju e keni dëgjuar emrin Jakup Krasniqi se ishte zëdhënësi

6 i UÇK-së, apo jo?

7 PË. Po. E njihja emrin e tij, e kisha dëgjuar emrin e tij, në

8 veçanti për shkak të pranisë së tij në Malishevë. Siç është

9 regjistruar nga ato çfarë na kanë thënë intervistat që ne kemi

10 intervistuar. Ata na kanë thënë që ai ishte zëdhënësi. Nuk

11 mund të them që e dija që ai ishte zëdhënësi, sepse siç e

12 thashë ne ishim të rinj me këtë mjedis. Dhe për të qenë të

13 singertë me ju, siç po mundohem që të jem në përgjigjet e

14 pyetjeve tuaja, nuk mendoj se e dija këtë informacion përpara

15 sesa të më thuhej që Jakup Krasniqi ishte zëdhënësi.

16 PY. Erdhi një pikë e caktuar që ju e kuptuat që z. Krasniqi

17 kishte rolin e zëdhënësit?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Dhe ju nuk e dini se kur ka ndodhur kjo ekzaktësisht, apo

20 jo?

21 PË. Jo.

22 PY. Përpara kësaj nuk e ke ditur as emrin e tij as rolin që

23 kishte z. Krasniqi, kështu?

24 PË. Mund të mos e kem ditur, domethënë, nuk mbaj mend që të

25 kem ditur se çfarë roli kishte ai apo që personi që quhej

1 ashtu si quhej.

2 PY. Keni thënë në deklaratën tuaj që ai ishte i njohur  
3 gjerësisht?

4 PË. Po.

5 PY. Për shkak të faktit se ai dilte në lajme dhe pasqyrohej  
6 në media si zëdhënës?

7 PË. Nuk kam pikë dyshimi që ishte kështu. Kjo duket e  
8 pranueshme për periudhën që unë kam qenë atje. Megjithëse unë  
9 personalisht nuk është se e kam parë atë në lajme në  
10 televizion apo nuk është se kam lexuar artikuj në media lidhur  
11 me të.

12 PY. As nuk e keni takuar personalisht, apo jo?

13 PË. Jo. Nuk e kemi takuar. Ne u përpoqëm që të bënim takime  
14 me të, sa i takon përpjekjeve përmes zinxhirit të komandës.  
15 Megjithatë, me sa më kujtohet informacioni im është që ose u  
16 refuzua takimi me ne ose nuk ia dolëm që të siguronim një  
17 takim me të. Nuk më kujtohet, kam përshtypjen që kolegët e mi  
18 kanë diskutuar me të. Megjithatë, nuk më kujtohet asgjë më sa  
19 i takon këtyre takimeve.

20 PY. A mund ta trajtojmë pak këtë çështje tani, ju lutem.

21 Sikurse e keni shpjeguar në deklaratat tuaja OSBE-ja ishte me  
22 departamente? Domethënë, ishte e ndarë në sesione të caktuara,  
23 domethënë, kishim oficerët e ndërlidhjes në Rahovec dhe ishte  
24 puna juaj që të kontaktonit me UÇK-në lokale në Rahovec, e  
25 saktë?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe këta ishin personat me të cilët kishin kontakte të  
3 përditshme?

4 PË. Nuk është se kishim kontakte të përgjithshme, po i  
5 takonim vazhdimisht ata.

6 PY. Edhe ju, si oficer ndërlidhës në zonën tuaj i takonit  
7 herë pas here atë, ndonjëherë?

8 PË. Është e rëndësishme të përmendet, të nderuar Gjykatës, se  
9 -- do ta shpreh ndryshe, në rajonin e Prizrenit ka zona të  
10 ndryshme ose ka pjesë përbërëse të ndryshme, njëra prej të  
11 cilave është Rahoveci. Të mendosh që Cobb-Smith dhe Andy  
12 Lefever kishin zonën e vetë të influencës. Domethënë, ata do  
13 kontrollonin ose do vizitonin këto zonat që ishin pjesë e  
14 përgjegjësisë së tyre sa më shpesh që të ishte e mundur.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'ju  
16 kërkoj të dyve që të jeni më të ngadaltë kur flisni për  
17 qëllime të Sekretarit të Seancës dhe të përkthyesve.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

19 PY. Zyrtari i ndërlidhjes në zonën tuaj jeni takuar në mënyrë  
20 të përditshme?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Puna e tyre ishte të takoheshin me përfaqësuesit e UÇK-së  
23 në atë zonë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] z. Dëshmitar,  
25 ju lutem bëni një pushim përpara se të përgjigjeni.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

2 Me sa kam kuptuar unë është që ata janë takuar me  
3 komandantët rajonal dhe ata që ishin poshtë tyre, oficerë të  
4 tjerë më të rinj, të nivelit më ulët.

5 Z. ELLIS: [Përkthim]

6 PY. Dhe kontaktet e mundshme me z. Krasniqi si zëdhënësi i  
7 UÇK-së do të kishin qenë OSBE-ja në Prishtinë, saktë?

8 PË. Kështu do e kuptoja dhe unë.

9 PY. Dhe personalisht nuk kishit dijeni për ndonjë kontakt apo  
10 takim që ai mund të ketë pasur me të tjerë, saktë?

11 PË. Jam informuar kur selia jonë -- do ta them ndryshe. Do të  
12 isha informuar nëse stafi nga zyra qendrore do ta kishte  
13 takuar atë. Nuk më kujtohet të jem informuar për lidhur me  
14 këto për ndonjë rast të veçantë. Kam një, më kujtohet turbull.  
15 E kam përmendur diku në një nga deklaratat e mia por nuk mund  
16 të them më shumë tani.

17 PY. Për sa i përket komenteve lidhur me bashkëpunimin e z.  
18 Krasniqi me OSBE-në në Prishtinë, ke ju diçka që ju kujtohet  
19 larg për një bisedë në Prishtinë?

20 PË. Disa nga gjërat që kanë ndodhur para 25 vjetësh më  
21 kujtohen qartë. Por kjo çështja e kontaktit mes z. Krasniqi  
22 nuk më kujtohet si diçka e rregullt që të ketë ndodhur në  
23 mënyrë të rregullt. Nuk më kujtohet, pra, që ka ndodhur në  
24 mënyrë të rregullt me ekipin tim më të lartë që ishin ekipi  
25 për të drejtat ekipi për të drejtat e njeriut.



1 Dhe më kujtohet që i kam pyet ata në mënyrë të përsëritur  
2 lidhur me këtë, në mënyrë të rregullt. Ata janë përgjigjur në  
3 mënyrë të rregullt sepse nuk kanë -- janë përgjigjur shumë  
4 mirë pyetjeve dhe lidhjeve që keni mbajtur.

5 PY. Dhe kur flisni ekipin për të drejtat e njeriut në  
6 Prishtinë bëhet fjalë për znj. Pederson?

7 PË. Z. Pederson dhe Sandra Mitchell që ka qenë drejtore për  
8 të drejtave e njeriut.

9 PY. E dini që z. Krasniqi ka mbajtur takime me OSBE-në dhe  
10 KDOM-in në Dragobil?

11 PË. Më kujtohet kjo. Po flasim për dhjetor apo nëntor të  
12 1998?

13 PY. Në përgjithësi po ju them, a jeni në dijeni që janë  
14 mbajtur takime?

15 PË. Po.

16 PY. A ju kujtohet që janë mbajtur takime me William Walker  
17 dhe të tjerë nga OSBE-ja në janar të 1999?

18 PË. Më kujtohet që më është thënë diçka e tillë dhe nuk kam  
19 arsye ta dyshoj këtë.

20 PY. Pra, personat të cilët duhet t'i pyesim për përmbajtjen e  
21 këtyre mbledhjeve duhet të jetë dikush tjetër jo juve, saktë?

22 PË. E saktë.

23 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me shënimet tuaja nga  
24 intervistat tuaja, të cilat ju janë treguar gjatë seancës  
25 përgatitore dhe pastaj dhe nga Prokuroria gjatë marrjes në

1 pyetje dje.

2 PË. Sigurisht.

3 PY. Po para kësaj, a mund t'ju tregoj një pjesë të shënimit  
4 përgatitor numër 2. Më duket se referenca është 114260 deri në  
5 114272.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për nevoja të  
7 procesverbalit ky duhet të jetë një numër prove P233.

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Më duhet shënimi  
9 përgatitor i dytë, numër 2.

10 PY. Ndoshta mund ta lexoj këtë pjesë për të cilën po flas.

11 Z. BAARLINK: [Përkthim] Nëse mund të ndihmoj me numrin  
12 ERN të shënimit përgatitor numër 2. 114249 deri tek 114252.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit. Besoj që mban numrin  
14 ERN.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkon [e  
16 pakuptueshme].

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se jemi në rregull të përdorin  
18 këtë referencë.

19 PY. Paragrafi 3, pra, që do të doja të shikonit.

20 PË. Po.

21 PY. Këtu thuhet:

22 "Kur u pyet nëse kishte burime të tjera përveç personave  
23 të emëruar në dokumente, dëshmitari deklaroj se intervistat  
24 ishin burim i vetëm".

25 PË. Kjo është në lidhje me pyetjen që bëri kolegu juaj,

1 mendoj, që ka dhënë raportimin qarkor. Besoj që mund të themi  
2 që nuk donim që secili dëshmitar të jepte deklaratën e tij në  
3 vend që të grumbullonim apo të kishin tregime të konsoliduara.  
4 PY. Dhe këto deklarata janë, përbëjnë bazën prej asaj që  
5 pastaj këto nëntë intervistat, shënimet për bazën e asaj që  
6 keni thënë më pastaj?

7 PË. Kam pasë qindra burime. Këto janë, këto intervista këtu i  
8 konsolidon, përfaqëson provat e dhëna, dëshmia e secilit  
9 dëshmitar pra. Njohuria ime bazohet në këto deklarata dhe në  
10 gjatë periudhës tre mujore e gjysëm apo katër mujore në atë  
11 zonë. Unë nuk e kam shumë të qartë atë që doni të thoni.

12 Ndoshta duhet të thoja që ishin i vetmi burim ndoshta kam --  
13 Z. BAARLINK: [Përkthim] Ndoshta do të jeni më të saktë,  
14 mbase do të qartësoni mënyrën se çfarë donte të thonte me  
15 këtë.

16 Z. ELLIS: [Përkthim]

17 PY. Ajo që ju thoni është që ky është burimi i vetëm i  
18 materialit të regjistruar në shënimet nga ato intervista?

19 PË. I vetmi burim për çfarë?

20 PY. Kur thashë, a ka burime të tjera apo "intervistat e  
21 dëshmitarit është një burim i vetëm"?

22 PË. Unë do thoja që janë burimi kryesor këto intervista. Po.  
23 Nuk kam pasë qasje në ato deklarata, për shembull, kur  
24 deklaratat e të afërmeve e kam fjalën, kur kam dhënë deklarata  
25 kësaj Gjykate.

1 PY. Këto pyetje do t'ju bëhen pastaj, sepse jua treguan këto  
2 dokumente gjatë fundjavës. Kur keni dhënë deklarata  
3 Prokurorisë nuk i kemi pasë këto deklarata.

4 PË. Do të thoja, siç e thashë më herët, që kur kam dhënë  
5 deklaratën e parë në TPNJ, në vitin 2000, kisha kopjen  
6 elektronike të disa dokumenteve tjera. Nuk më kujtohen saktë  
7 cilët. Gjithashtu do thoja që kjo është një periudhë shumë e  
8 fuqishme emocionalisht e jetës sime dhe më kujtohen gjërat në  
9 detaje.

10 PY. Të kuptoj. Dhe gjatë intervistave, keni pasë përkthyes  
11 serbë që t'ju ndihmojë?

12 PË. Po.

13 PY. Besoj që keni thënë që kanë qenë dhe dy-tre staf tjerë me  
14 juve?

15 PË. Ne ishim të shqetësuar dhe kjo është praktikë e  
16 organizatës në përgjithësi, të paktën jo nga rajoni jonë, që  
17 të mos komprometohen njerëzit, të mos mbahen kontakte afërt me  
18 grupe të caktuara burimesh. Më kujtohet që këtu kemi pasur një  
19 qasje pak më ndryshe. E njoh përkthyesin në këtë rast, të  
20 paktin njërin prej tyre, e di që ka qenë shumë i përfshirë në  
21 këtë proces. Ajo ka pasë të afërm vetë. Por kemi përdorur  
22 përkthyes të tjerë, nuk më kujtohet saktësisht cili prej tyre  
23 ka marrë pjesë gjatë marrjes së deklaratë.

24 PY. E kuptoj.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të dy juve po

1 flisni njëkohësisht. Duhet që të bëni pak pushim mes pyetjeve  
2 dhe përgjigjeve.

3 Z. ELLIS: [Përkthim]

4 PY. Pra, presa u përket personave të pranishëm gjatë  
5 intervistës keni qenë ju dhe një përkthyes që mund të jetë  
6 njëri prej disa përkthyesve që keni pasur ju?

7 PË. Po, mos dy apo tre përkthyes, njëri prej dy a tre  
8 përkthyesve i kemi pasur.

9 PY. Dhe keni marrë shënime me dorë juve vetë gjatë kësaj  
10 interviste?

11 PË. Besoj që po. Por nuk më kujtohet. Po kjo ka qenë praktikë  
12 e përgjithshme që kam patur.

13 PY. Dhe çka përgatitjesh për deklaratat tuaj apo intervistat  
14 tuaja nuk ju janë treguar ndonjëherë këto shënime me dorë?

15 PË. E keni fjalën për këto deklaratën që kam dhënë?

16 PY. Deklarata para TPNJ-së dhe që keni dhënë.

17 PË. Kam pasë një fletore por fletorja fillon, më duket, pak  
18 pas apo rreth periudhës së krishtlindjeve dhe ndoshta pas dhe  
19 nuk përmban këto deklarata në veçanti.

20 PY. Pra, nuk e kishit rishikuar këto shënime me dorë që keni  
21 pasur, e saktë? Dhe pastaj i keni shtypur në makinë shtypi?

22 PË. Më kujtohet që e kam bërë këtë me një përkthyes në  
23 veçanti në zyrën në Rahovec. Më kujtohet kush është ajo.

24 Ndoshta nuk më kujtohet emri i saj, po më kujtohet shumë mirë  
25 personi. Dhe i kemi shtypur së bashku pra.

1 PY. Duke patur gjithë detyrat tjera që kishit në atëkohë,  
2 besoj që nuk i keni shtypur menjëherë këto shënime që kishit  
3 marrë me dorë?

4 PË. Jo, por ka qenë një lloj urgjence, janë bërë në një farë  
5 urgjence. Me sa më kujtohet nuk i kemi marrë deklaratat  
6 njëkohësisht, në të njëjtën kohë. Në fakt, tani që po e mendoj  
7 që përmendni, mund t'i kemi marrë në të njëjtën kohë këto  
8 deklaratat.

9 PY. Atëhere përgjigja jua para pak çastesh ishte:

10 "Që nuk i keni marrë deklaratat në të njëjtën kohë"

11 PY. Po. Nuk më kujtohen detajet mirë. Megjithatë, më kujtohet  
12 që i kam shtypur këto deklaratat ose ndihmësi im që i ka  
13 shtypur këto deklaratat dhe unë që kam qenë i ulur afër saj që  
14 po i shtypte në kompjuter. Tani a është bërë kjo në prani të  
15 ndonjërit prej bashkëbiseduesve tanë, të them të drejtën nuk  
16 më kujtohet. Nuk më kujtohet.

17 PY. Mbase e kuptoj. Edhe është e kuptueshme kanë kaluar 25  
18 vjet.

19 Sa ju kujtohet që kanë zgjatur këto intervista me secilin  
20 prej të intervistuarve?

21 PË. Aq kohë, aq gjatë sa duhet për të marrë informacionet,  
22 Pra që të jemi të saktë, do thoja secili prej tyre rreth një  
23 orë.

24 PY. Pash datat në dokumente, pashë që pesë intervista janë  
25 mbajtur në 5 janar 1999, është e saktë?

1 PË. Po, e saktë

2 PY. Pra, po thoni pesë intervista me një përkthyes?

3 PË. Mund të ma kujtoni ju. Po mund të jetë që u është kërkuar  
4 të intervistuarve që të mblidhen të takohemi në kishë në Hoçën  
5 e Madhe. Dhe mund të ketë qenë tre orë, mund të ketë qenë  
6 tetë. Ka qenë punë e një dite.

7 PY. Dhe nuk ju kujtohet sesa ka zgjatë intervista e secilit  
8 prej këtyre?

9 PË. Siç e thatë ju, kjo nuk ka qenë hetim penal. Qëllimi i  
10 kësaj ishte të përpiqeshim të gjendnim ku janë këta njerëz,  
11 vendndodhjen e njerëzve. Pra, formalitetet e një procesi  
12 ligjor nuk kanë qenë përparësi në punën që kemi bërë në ne në  
13 atë kohë në luftë.

14 PY. Do t'ju lexoj një pjesë tjetër nga i njëjti shënim  
15 përgatitor. Ku jeni pyetur nga Prokurori nëse personat e  
16 intervistuar kanë pasë mundësi që të rishikojnë deklaratat e  
17 tyre. Përgjigja juaj ka qenë mendojmë se duhet të ketë qenë  
18 praktikë, po nuk më kujtohet.

19 PË. Kjo është e saktë.

20 PY. Këto kanë ndodhur para 25 vjetësh. Nuk ju kujtohen?

21 PË. Në këtë pikë në veçanti është ashtu siç thoni ju.

22 PY. Por pranoni nëse një person e rishikon deklaratën, është  
23 praktikë e mirë që t'i kërkonit atyre që të firmosin  
24 deklaratën, ta nënshkruajnë atë apo të shënojnë diçka?

25 PË. Tani përgjigje përsëri që formaliteti ligjor nuk ka qenë

1 përparësi apo gjë e rëndësishme për ne në atë moment, në ato  
2 rrethana, në netët e ftohta të dimrit, gjatë luftës, në një  
3 shtëpi të priftit, me të afërt njerëzit që ishin zhdukur që ne  
4 duhet t'i gjenin, që nuk i kanë gjetur kurrë. Duhet të isha  
5 treguar më i kujdesshëm ndoshta, t'i kisha kushtuar më shumë  
6 vëmendje për të plotësuar kushtet e marrjes së një deklaratë,  
7 por duke pasë parasysh, por besoj që jemi detyruar nga  
8 rrethanat të veprojmë siç kemi vepruar.

9 PY. Po ju e dini se asnjë nga këto deklarata nuk përmbajnë  
10 nënshkrim apo iniciale, apo një konfirmim të dorëshkuar?

11 PË. Pajtohem me këtë. Këto janë kopje elektronike.

12 PY. Dhe, në fakt, këto shënime janë të vetmet shënime të  
13 shkruara të ndonjë kontakti që keni pasë me këta individë?

14 PË. Po, që unë i kam, pos që i zotëroj, po.

15 PY. Dhe dje thatë që mënyra sesi janë marrë këto deklarata,  
16 erdhi një moment kur keni vendosur që të formalizoni tregimet  
17 e këtyre me qëllim që të raportoni dhe të ndihmoni veten për  
18 në hetimet, kjo është ajo që ju ka bërë të shënoni këto  
19 intervista?

20 PË. Besoj që është përmbledhje e saktë kjo që thatë.

21 PY. Dhe gjatë formalizimit të këtyre tregimeve keni dashur që  
22 të përfshini gjithë informacionet e rëndësishme që u janë  
23 dhënë?

24 PË. Po.

25 PY. Dëgjuam Prokurorinë që lexoi përmbledhjen tuaj dje, ishin



1 dy persona që ju kanë thënë që Jakup Krasniqi ka qenë i  
2 pranishëm në qendrën e ndalimit në Malishevë dhe këta dy  
3 persona kanë qenë Snezana dhe Slavka Baljosevic?  
4 PË. Kështu duket nga shënimet, nga evidenca. Besoj që po të  
5 kishte parë dikush tjetër këto persona do të ishin shënuar  
6 regjistruar diku, evidentuar dhe nuk më kujtohet që ka ndodhur  
7 kështu dhe këta ishin të bindur për këtë.

8 PY. Ne i kemi shënimet e nëntë të intervistuarve dhe nuk ka  
9 asnjë lloj reference lidhur me praninë e mundshme të z.  
10 Krasniqi aty.

11 PË. Atëhere meqë thoni ju kështu.

12 PY. Dhe nuk përmendni në deklaratën tuaj që keni ndërmarrë  
13 ndonjë hap për t'i verifikuar identifikimin e z. Krasniqi, a  
14 është kështu?

15 PË. Znj. Baljosevic, të dyja znj. Baljosevic ishin të bindura  
16 të qarta lidhur me këtë identitetin e individit. Siç e thashë,  
17 siç e thatë edhe ju, ky ishte një individ i njohur, i njohur  
18 mirë dhe shumë njerëz e njihnin atë si zëdhënësi i UÇK-së. Dhe  
19 nuk më kujtohet pse s'e kanë njohur.

20 PY. Më fal, po bëja pyetjen ju lutem. Pyetja ime ishte ju nuk  
21 e keni verifikuar këtë gjë. Edhe kur thoni që mendoni që kjo  
22 është diçka që po e thoni tani pas 25 vitesh. Nuk është  
23 verifikim që keni bërë në atë kohë.

24 PË. Pyetja ime për juve është për t'u qartësuar përgjigjen  
25 çfarë procedure sugjeroni ju që një person do të duhet të

1 kishte përdorur, zbatuar në këto rrethana?

2 PY. Do të duhet të kishit kërkuar një përkthim të detajuar  
3 të z. Krasniqi.

4 PË. Vendi, mundësitë që kishim në atë kohë ishin ashtu siç  
5 ishin. Dhe siç e shihni, më lejoni të përfundoj, qëllimi i  
6 asaj që po bëja unë në atë kohë apo këto deklaratat themi nuk  
7 do të përdreshin në një gjykatë penale 25 vjet më vonë. Ato  
8 ishin për të na informuar neve për atë që kishte ndodhur.

9 Nuk jam kundërshtuar me që ra deri në këtë moment që z.  
10 Krasniqi ka qenë aty. Nuk asgjë nuk mohon praninë e tij aty.  
11 Por që ta përsëris, që të jemi të saktë, qëllimi i këtyre  
12 deklaratave ishte që të informoheshim ne dhe të përpiqeshim të  
13 gjenim të zbulonim fatin e njerëzve që tani e dimë janë të  
14 vdekur dhe të varrosur, por gjë që nuk e dinim në atëkohë. Në  
15 fillim të janarit ka qenë, në fillim nuk kishim mund mundësi  
16 që ta bënim këtë gjë të tillë, pra, qëllimi ishte që të  
17 përpiqeshim të gjenim, ne po përpiqeshim të gjenim atë.

18 PY. Më lejoni të kthehem tek përgjigja juaj:

19 "Asgjë nuk më mohonte praninë deri në këto moment,  
20 praninë e z. Krasniqi në atë kohë, s'kishim asnjë element që  
21 mohonte praninë e tij".

22 Pra, ju s'keni pasë asnjë kontakt me z. Krasniqi as më  
23 përpara, pra, kur thoni që asgjë nuk mohonte praninë e tij ju  
24 as nuk e keni pyetur atë?

25 PË. Jo, nuk e kam patur këtë mundësi. Derisa nuk e kam patur

1 këtë mundësi, këtë kënaqësi që të flas me të që besoj që është  
2 një njeri shumë i ngritur dhe i respektuar. Gjithashtu,  
3 deklarata që z. Krasniqi trajtuar dy informatorë mirë dhe ata  
4 kanë qenë të -- u kanë lënë mbresa të mira, pra, atyre.

5 PY. Një pikë tjetër të cilën do të doja të diskutoja është të  
6 kthehesha: A keni marrë përshkrim të detajuar të personit që  
7 thuhet të ishte Jakup Krasniqi, po ose jo?

8 PË. Jo.

9 PY. Dhe kur thoni që s'keni pasë kushtet në atë kohë, kjo  
10 ishte, bëhet fjalë për dy-tre pyetje më shumë?

11 PË. Në qoftë se ju pohoni që unë kam qenë i pakujdesshëm në  
12 kryerjen e detyrave të mia, i pakujdesshëm do ta pranoj, por  
13 do të thoja që isha për të zbutur pozitën time ishte që isha i  
14 stërlodhur në atë dhe isha i kufizuar në atë që mund të bëja.

15 PY. E kuptoj këtë. Kuptojmë shumë mirë rrethanat në të cilat  
16 keni punuar.

17 PË. Uroj që t'i kuptoni.

18 PY. Dhe meqë ra fjala do të shtoja, pavarësisht rrethanave të  
19 mia, rrethanat e vetë viktimave dhe të afërmeve të tyre që  
20 ishin në gjendje shumë të rëndë --

21 PY. Do të kthehemi tek kjo pak më vonë. Çështje nuk është  
22 aty, si avokat, që keni praktikuar zanatin e avokatit për disa  
23 vite --

24 PË. Po, e kam praktikuar.

25 Dhe në qoftë se po përsëris përgjigjen time. Në qoftë se

1 kjo kritikë personale se nuk kam bërë identifikimin e duhur,  
2 verifikimet e duhura do ta -- ua lejoj këtë dhe nuk kam nevojë  
3 që të kundërshtojë të shkoj më tej në këtë çështje.

4 PY. Ju keni bërë ndjekje penale dhe keni qenë në anën e  
5 Mbrojtjes në përpara gjykatave angleze?

6 PË. Besoj që po.

7 PY. Pa dyshim që keni qenë, je përballur me çështje të  
8 verifikimit të personave në çështje penale?

9 PË. Do përsëris përgjigjen time, nuk jemi të përgatitur që  
10 kjo çështje do përfundojë në ndonjë gjykatë.

11 PY. Dhe si rezultat i kësaj nuk është, nuk ka qenë pjesë e  
12 punës tuaj për të bërë hetime mbi vërtetësinë e identifikimit,  
13 saktë?

14 PË. Nuk e kuptoj pyetjen? Qëllimi i hetimit tim ka qenë për  
15 të gjetur vendndodhjen e personave të zhdukur apo për  
16 personave të cilët kishin ndonjë arsye për të menduar që të  
17 paktën disa prej tyre mund të ishin akoma gjallë në atëkohë.

18 PY. Pra, keni marrë informata nga viktimat dhe jeni ndalur  
19 aty. S'keni bërë ndonjë hetim më tej apo ndonjë për të  
20 vërtetuar faktin nëse z. Krasniqi ishte apo s'ishte aty.

21 PË. Në të kundërtën. Këto deklarata që ju keni janë  
22 transmetuar tek selia e OSBE-së të cilit ishin gjerësisht të  
23 informuar për përfshirjen e z. Krasniqi në këtë çështje. Dhe  
24 në fakt në fillim të marrjes tuaj në pyetje biseduam për  
25 faktin nëse ishte apo s'ishte i pranishëm dhe shkallën në të

1 cilin niveli i njohurisë të zyrtarëve të lartë të OSBE-së.

2 Dhe një prej arsyeve që departamenti për të drejtat e  
3 njeriut duhet të kishte kontaktuar atë ka qenë sepse për shkak  
4 të këtyre pohimeve të bëra nga të afërmit e viktimave.

5 PY. Në situatat kur emocionet janë të përfshira mund të  
6 ndikojnë negativisht në procesin e identifikimit?

7 PË. Besoj që kjo nuk ka ndodhur sepse ju keni pohuar vetë që  
8 z. Krasniqi është individ i njohur mirë që njihet nga të  
9 gjithë dhe ata e kanë njohur atë, e kanë identifikuar. Mund të  
10 ketë qenë dikush që dukej si Jakup Krasniqi por nuk kam qenë  
11 aty në atë kohë. Megjithatë ata kanë qenë të bindur se ishte  
12 ai.

13 PY. Do të kthehemi në hollësi. Një moment. Por më lejoni të  
14 them këtë, në një intervistë me Snezana Baljosevic, ajo që  
15 keni thënë në shënimin përgatitor keni thënë që:

16 "...ka qenë jashtëzakonisht e vështirë për atë për arsye  
17 të kuptueshme. Ishte shumë emocionale, emocionoj shumë dhe  
18 ishte e mërzitur dhe e irrituar në krahasim me tjerët".

19 "Të tjerët" ju i referoheni ata që keni intervistuar?

20 PË. Po.

21 PY. Keni përmendur dhe Slavka Baljosevic që ishte  
22 "jashtëzakonisht e nervozuar, e pakënaqur dhe emocionale dhe e  
23 idhnuar", a është e saktë?

24 PË. Duhet të ketë qenë kështu.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të nxjerrim në ekran ju

1 lutem, shënimet e intervistës që ka numrin SPOE40010571. Më  
2 duket që janë të shënuara për identifikim kështu që duhet të  
3 jenë me prova numër P235.

4 PY. Tani, këtu në kënd kemi këtë deklaratë të parë e cila ka  
5 të bëjë me rastet më duket Dusko Dolasevic dhe Djordje  
6 Baljosevic.

7 Natyrisht që ju e shqiptoni shumë më mirë se unë. Kjo  
8 është një nga deklaratat që keni marrë, a është e saktë?  
9 PË. Po.

10 PY. Dhe ka të bëjë me kidnapimin e këtyre dy individëve pasi  
11 kishin shkuar në Termoment për të përfunduar një punë.

12 PË. Kështu është.

13 PY. Nëse vazhdojmë më tej, shfletojmë dhe kalojmë tek faqja  
14 575, në fund të kësaj faqeje, ju lutem, këtu fillon deklarata  
15 e Snezana Baljosevic.

16 PË. Po.

17 PY. Dhe në paragrafin 1 ajo përshkruan, se ishin pesë vetë në  
18 makinë.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Paragrafi 2, kërkoj ndjesë.

20 PY. Thotë që ajo vetë, bebi i saj, vjehrra e saj. Pesë  
21 persona, ajo, vjehrra, Sasa Baljosevic dhe bebi, foshnja. Pesë  
22 vetë.

23 PË. Përgjigje kështu duket.

24 PY. A mund të shkojmë tek deklarata dhënë para TPNJ-së. Në  
25 fund të faqes numër 8, ju lutem.

1 PY. Dhe aty thoni për njëri nga Baljosevic se po kthehej nga  
2 pushimi me Sasa dhe Djordjen.

3 Ju e keni bërë këtë gabimisht sepse ai është i përfshirë  
4 në një incident tjetër?

5 PË. Po ashtu duket.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kthehem tek deklaratat e  
7 mëparshme në faqen 14 të asaj deklaratate.

8 PY. Dhe aty është një pjesë me titullin "Jakup Krasniqi". Dhe  
9 aty thoni që:

10 "Slavka Baljosevici kishte deklaruar se ai ishte personi  
11 i parë që ajo kishte parë kur kishte arritur në objektin e  
12 ndalimit".

13 A e shikoni këtu?

14 PË. Po.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kthehem tek dokumenti  
16 tjetër që është prova materiale 235. Është faqja që mbaron me  
17 numrat 576.

18 Më falni, do ta kontrolloj edhe njëherë numrin, shënimet  
19 e mia. Më falni, numri i faqes është 577.

20 PY. Në qoftë se e kam numrin e faqes që duhet, z. Ledwidge,  
21 aty do ta shikoni deklaratën e Slavka Baljosevic, a është  
22 kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Kërkoj që t'i hidhni një sy paragrafit numër 4. Dhe duhet  
25 ta shikoni se aty ajo thotë:

1 "Menjëherë na çuan tek Jakup Hoti që ishte personi

2 kryesor i UÇK-së në Malishevë".

3 PË. Po.

4 PY. Siç e shikoni përsëri ka një farë ngatërrese në

5 deklaratën që ia keni dhënë Tribunalit të Hagës, në deklaratën

6 e juaj thoni që personi i parë që ka parë ajo kur ka arritur

7 atje ka qenë Jakup Krasniqi, kurse në deklaratën për

8 tribunalin thoni Jakup Hoti.

9 Shumë kollaj është të bëhet gabim kur janë dy emra të

10 njëjtë.

11 PË. Më falni, a është kjo një pyetje që ma bëni mua apo vetëm

12 koment i juaj?

13 Deklarata që ia dhashë tribunalit me sa më kujtohet është

14 bërë pa iu referuar këtyre deklaratave. Mirëpo në deklaratat e

15 mëparshme që keni përpara do të kisha thënë që informacioni

16 është më i saktë.

17 PY. Ju, sigurisht, që do ta pranoni se mund të kishin ndodhur

18 gabime në deklaratat që i keni dhënë Tribunalit të Hagës sepse

19 ju i keni kujtuar vetme ato ngjarje që kanë qenë të kohës kur

20 janë bërë shënimet, a është kështu?

21 PË. Nuk është bërë gabimi se ata të dy e kanë emrin Jakup, z.

22 Ellis. Por është gabim që bazohet në kujtesën time. Aty është

23 thjesht dështim i kujtesës.

24 PY. Në qoftë se Slavka Baljosevici ua ka përmendur Jakup

25 Krasniqin kur keni përfunduar, formalizuar deklaratat, ju do



1 ta kishit shënuar këtë, apo jo?

2 PË. Po a nuk është ky informacion në faqe në vijim?

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shkojmë tek faqja në vijim?

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Duket se është ashtu siç  
5 thatë.

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 PY. Po. Nuk ka asnjë shënim në atëkohë që ajo t'ju ketë thënë  
8 se Jakup Krasniqi ka qenë aty, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Duket që është ashtu, z. Ellis.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani t'i kthehemi dokumentit në  
11 faqen 574. Përsëri nuk e dhashë numrin e saktë. Është  
12 deklarata e Snezana Baljosevic do ta gjej numrin e faqes në  
13 kopjen e shtypur që kam përpara. Fillon me numrat 575. Duhet  
14 të jetë në fund të faqes 575 kjo pjesë e deklaratës.

15 PY. Nëse shkoni në fund të faqes, krejtësisht në fund të  
16 paragrafit 3.

17 "... një mik i familjes që ishte në UÇK më tregoi se  
18 komandant ishte Jakupi dhe se ky mik ishte dikush me mbiemrin  
19 Hoti".

20 Kjo tregon se ajo nuk e ka pa vetë Jakup Krasniqin por se  
21 dikush tjetër ia ka tregu këtë informacion?

22 PË. Duket se është ashtu, po.

23 PY. Dhe referenca atëherë për Jakup Hotin në atë deklaratën  
24 që e përmendën duhet të jetë për Jakup Hotin?

25 PË. Për cilën deklaratë e keni fjalën?

1 PY. Për deklaratën tjetër. A ka dhe një person tjetër me  
2 emrin Hoti që mund të jetë i përfshirë?

3 PË. Nuk e di. Nuk mund të them asgjë. Nuk më kujtohet se kush  
4 tjetër mund të ma ketë thënë këtë informacion se z. Krasniqi  
5 ka qenë atje. Më kujtohet që në lidhje me këtë kam biseduar me  
6 kolonelin Petrovic. Kam bërë shënim në fletoren time dikund në  
7 mesin e marsit apo fundin e marsit, z. Krasniqi bënte  
8 deklaratat nga Malisheva, kështu që ne ishim bukur të  
9 vetëdijshëm apo në dijeni që z. Krasniqi ishte atje. Mirëpo  
10 mesa duket këto deklaratat nuk e mbështesin këtë.

11 PY. Deklaratat që ju keni shkruar nuk e mbështesin këtë  
12 informacion, z. Ledwidge, a s'është kështu?

13 PË. Nga ajo që ju e thoni del që është ashtu siç thoni.

14 PY. Në deklaratë thuhet se -- ju thoni se koloneli Petrovic  
15 ju ka treguar që Jakup Krasniqi ka qenë atje?

16 PË. Po, ashtu është. Është referenca e vetme që më kujtohet  
17 në lidhje me z. Krasniqi dhe praninë e atij atje. Nuk vihet në  
18 diskutim çështja e pranisë së z. Krasniqi atje, sepse ai ka  
19 qenë atje, mirëpo nuk më kujtohet se nga ku vinte ky  
20 informacion. Kjo ishe dhe logjika apo arsyeshmëria mbi të  
21 cilën mbështeteshin njerëzit e Rahovecit dhe qëllimi dhe  
22 kërkesat e vazhdueshme të drejtuesit të ekipit tim për të  
23 folur me z. Krasniqi. Kishte shumë burime që konfirmonin se ai  
24 ishte i pranishëm aty, mirëpo mu nuk më kujtohet se cilët  
25 ishin këto burime dhe kjo do të ishte përgjigja më e mirë e

1 imja në këtë pyetje, z. Ellis.

2 PY. Domethënë, ju vini këtu para një Gjykate Penale dhe thoni  
3 që ka burime të tjera po dhe ato s'ju kujtohen?

4 Z. BAARLINK: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
6 kundërshtimi.

7 Z. ELLIS: [Përkthim]

8 PY. Dhe kolonel Petrovic ishte ai torturuesi që e përmendët  
9 më herët, apo jo?

10 PË. Kolonel Petrovic ishte komandant apo zëvendëskomandant,  
11 besoj, i forcave policore në Prizren. Dhe nuk ka dyshim që ai  
12 ka përkrahur apo edhe vetë ka marrë pjesë në praktika të tilla  
13 të torturës.

14 PY. Dhe ai ju ka pranuar që kur e keni pyet ju që ka pasë  
15 gjak në mure.

16 PË. Po. Dhe, z. Ellis, nga shënimet e mia, e keni këtë  
17 informacion se është marrë nga ajo bisedë.

18 PY. Po a nuk mendoni që këto ngjarje, pala serbe i ka  
19 përdorur për nevoja propaganduese, apo jo?

20 PË. Ata e përdornin çështjen e të zhdukurve si provokim. Kjo  
21 është e saktë.

22 PY. Dhe do të ishte me vlerë për palën serbe që ta lidhnin,  
23 asocionin personazhin e zëdhënësit të UÇK-së me atë ngjarje, a  
24 është kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Por, sidoqoftë, serbët, qeveria e serbëve nuk ngriti  
2 ndonjë problem, nuk e bënë të madhe praninë e tij atje, po për  
3 sa i përket vetë njerëzve të Rahovecit dhe familjarëve të të  
4 zhdukurve kjo kishte me rëndësi.

5 PY. Dhe ju vetë nuk i ndiqnit mediat shqiptare në atë kohë?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe nuk jeni në dijeni të deklaratave publike që i ka  
8 bërë z. Krasniqi në atë kohë, është kjo e saktë?

9 PË. Po.

10 PY. Nuk keni qenë në gjendje të ndiqni, domethënë, këto  
11 informacione për periudhën 17 deri në 26 korrik kur kanë  
12 ndodhur edhe këto ndalime të pretenduara?

13 PË. Unë po e përsërisë nuk kam ndjek mediat shqipe në lidhje  
14 me këto ngjarje.

15 PY. Në qoftë se shkoni tek paragrafi numër 6 aty thuhet:

16 "Hoti ishte aty dhe tha që kur komandant Krasniqi shkoi  
17 në Shqipëri ai vetë i liroi të burgosurit e tjerë".

18 Thuhet kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Po këtë nuk e keni hetu ju vetë në qoftë se z. Jakup  
21 Krasniqi shkoi në Shqipëri në korrik të 1998?

22 PË. Nuk kam mund ta hetoj atë.

23 PY. Ai nuk ka shkuar në Shqipëri në korrik 1998 dhe kjo është  
24 një nga arsyet që do të sugjeronte se ky identifikim i tij  
25 është i gabuar.

1 Këto dy intervista janë kry më 28 dhjetor dhe 9 janar,  
2 është e saktë?

3 PË. Ashtu duket nga dokumenti ,nga datat në dokument.

4 PY. Dhe dy personat janë të lidhur familjarisht apo jo? Janë  
5 vjehrrë dhe nuse?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe është e mundur që gjatë këtyre pesë muajve, nga vetë  
8 ngjarjet e deri në kohën e intervistës, ato të kenë diskutuar  
9 ngjarjet mes veti?

10 PË. Po, është e mundur.

11 PY. Pastaj ndoshta edhe vetë intervistuesit mund të kenë  
12 diskutu në mes vete, a është kjo e saktë?

13 PË. Po.

14 PY. Më pas thuhet se një ditë më vonë në Malishevë, Jakup  
15 Hoti ka sjellë një anëtar të familjes Lukic në dhomën ku kanë  
16 qenë anëtarët e familjes Baljosevic, a ju kujtohet ndonjë  
17 ngjarje e tillë?

18 PË. Kam një kujtesë të vagullt në lidhje me këtë.

19 PY. Ju e keni intervistuar Jovan Lukic, a është e saktë?

20 PË. Po.

21 PY. Do ta shohim deklaratën e tij nga fundi i këtij  
22 dokumenti. Mendoj që fillon në faqen 578. Ai këtu ju thotë se  
23 e kanë çuar në Malishevë se është mbajt ndaras nga anëtarët e  
24 tjerë të familjes, është mbajt me grup burrash, a është e  
25 saktë?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe në deklaratën e tij nuk përmendet Jakup Krasniqi, a  
3 është e saktë?

4 PË. Ashtu duket.

5 PY. Nuk kemi shënime nga intervistat me anëtarë të tjerë të  
6 Lukic sepse nuk keni biseduar me ta, është kjo e saktë?

7 PË. Po, e saktë. Më kujtohet që z. Lukic, ndoshta nuk është e  
8 njëjta familje. E di që z. Lukic nuk na kontaktoi. Unë shkova  
9 për ta vizituar në shtëpinë e tij. Më kujtohet që ka qenë  
10 vetëm. Kështu më kujtohen ngjarjet nga ky moment kohor.

11 PY. A e dini se në vitin 2006, Krunislava Baljosevic ju dha  
12 një fotorrestim për identifikim dhe se ajo nuk identifikoi  
13 Jakup Krasniqin në atë fotorreshtim.

14 PË. Nuk e kam ndjekë çështjen mbas largimit tim në lidhje me  
15 asnjë prej këtyre individëve.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani do të shikojmë në ekran  
17 dokument me numër 00194018, faqe numër 4. Më falni, të shkojmë  
18 tek faqja tjetër.

19 PY. Shikoni listën e fotografive që i është treguar dhe e  
20 shikoni në ekran fotografinë e Jakup Krasniqit, fotografia 5,  
21 7 dhe 14? E shikoni këtë?

22 PË. Po.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani të shkojmë tek dokumenti  
24 00194062 deri në 194084-RED3.

25 PY. Dhe aty e shikoni që është një intervistë me Krunislava

1 Baljosevic?

2 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të shikojmë tek faqja

3 00194081.

4 PY. Ta kalojmë shpejt e shpejt. Duhet të mbulojmë një pjesë  
5 të kësaj faqeje dhe të faqes tjetër. Fotografia 5: "Nuk e di".

6 Fotografia 7: Nuk e di emrin. Nuk di asgjë".

7 Dhe në faqen tjetër, fotografia numër 14: "Asgjë..."

8 është përgjigjja e saj.

9 PË. Po.

10 PY. Siç konfirmuat edhe ju kur keni përgatitur dëshminë tuaj  
11 ju nuk mund të konfirmoni në lidhje me deklaratën e znj.

12 Baljosevic?

13 PË. Unë mund vetëm të përgjigjem për deklaratën time dhe  
14 dëshminë time.

15 PY. A e dini që ka dhënë një deklaratë edhe në departamentin  
16 e punëve të brendshme në Rahovec përpara se të fliste me ju?

17 PË. Jo.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shkojmë tek dokumenti U000-5328.

19 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kundërshtoj. Dëshmitari nuk ka  
20 dijeni për atë deklaratë dhe nuk e di se cili është qëllimi i  
21 kësaj pyetjeje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
23 rrëzohet.

24 Vazhdoni z. Ellis.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

1 PY. Mund të shikoni aty nga ana e djathtë e ekranit është  
2 deklaratë e 31 shtatorit 1998, Krunislava Baljosevic?

3 PË. Po.

4 PY. Mund të merrni kohën ta lexoni, por unë mund t'ju them që  
5 nuk përmendet Jakup Krasniqi në atë dokument.

6 PË. E pranoj atë që thoni. Unë nuk di për këtë dokument,  
7 sikur ta kisha ditë këtë deklaratë do ta ma kishte lehtësu  
8 edhe mu punën në atëkohë. Sepse dhe serbët nuk ndihmonin aq  
9 shumë.

10 PY. Ju me siguri pajtoheni dhe e dini që mbiemri Krasniqi  
11 është një mbiemër i zakonshëm dhe i shpeshtë në Kosovë dhe në  
12 zonën e Malishevës, a është kështu.

13 PË. Po.

14 PY. Ju konfirmuat se nuk kishit dijeni për strukturën e UÇK-  
15 së në Malishevë ashtu siç ishte në korrik në '98.

16 PË. Po.

17 PY. Nuk mund të na jepni prova faktike në lidhje me zinxhirin  
18 komandues funksional në atë kohë?

19 PË. Këtë e kemi diskutu gjerësisht dje, jo.

20 PY. Dhe shpresoj që nuk keni, mendoj që nuk keni qenë në  
21 gjendje të flisni me z. Jakup Hoti apo me ndonjë person tjetër  
22 që e përmendët?

23 PË. Përmenda Sosin, Sabahudin Cenën dhe disa persona të  
24 tjerë.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë private



Dëshmitari: W02153 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 89

1 për një kohë të shkurtër?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në  
3 seancë private, Sekretare.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W02153 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 91

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W02153 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 92

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W02153 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 93

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
11 jemi në seancë publike.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Do kërkoja që të shfaqej në ekran  
13 dokumenti SPOE00186138 [sipas përkthimit] që jam i sigurt që  
14 është caktuar një numër prove materiale. Ju kërkoj ndjesë që  
15 nuk e kam këtë numër prove materiale përpara meje. Përfundon  
16 me 247, nëse nuk e kam gabim.

17 PY. Besoj se këtë dokument e diskutuat më herët me z. Strong.  
18 PË. Po.

19 PY. Ky është një raport që nënshkruhet nga z. Macleod. Të  
20 paktën emri është nga z. Macleod. Dhe ju konfirmuar që të  
21 paktën pjesë të këtij raporti janë hartuar prej jush.

22 PË. Po. Besoj se pjesa dërrmuese e tij është hartuar prej  
23 meje.

24 PY. A mund të kalojmë te faqja e fundit e këtij dokumenti.  
25 Jam i interesuar të shohim paragrafin numër 5.

1 PË. Po.

2 PY. Në qoftë se keni mundësi që ta lexoni se shihni më mirë  
3 sesa unë. "Është një përmbledhje e informacionit aktual. Pra,  
4 informacion që e çon zyrën tuaj që të besojë se kjo ka  
5 ndodhur".

6 "Jakup Hoti është nëpunës, është oficer i lartë i njësisë  
7 në Malishevë. Mund të ketë qenë një Jakup Krasniqi gjithashtu  
8 një person në komandë".

9 PË. Po.

10 PY. Domethënë ky është dokumenti i i cili përfshin dy emra  
11 apo jo?

12 PË. Po, kjo është e sakë.

13 PY. Juve ju janë dhënë nga autoritetet serbe lista të tëra të  
14 personave të dyshuar të cilët ju i keni përmendur edhe në  
15 deklaratën e TPNJ-së?

16 PË. Po.

17 PY. Në asnjë prej atyre listave të dyshuara nuk ishte emri i  
18 Jakup Krasniqit apo jo?

19 PË. Nuk më kujtohet. Sikurse e kam thënë shumë herë gjatë  
20 ditës së sotme, nuk më kujtohet dhe detyra ime kryesore ka  
21 qenë që të identifikonim vendin e personave të zhdukur.

22 PY. Kam një çështje të fundit që dëshiroj t'ju paraqes, sa i  
23 takon dokumenteve. Dua që të paraqitet në ekran dokumenti  
24 DJK00206. Ju lutem paraqisni faqen DJK00216, të këtij  
25 dokumenti. Pra, dokumenti 206, në faqen 216.

1 A e dini që informacionet që mblidhnit ju është rishikuar  
2 ose analizuar nga UNMIK-u në 2006, z. Ledwidge?

3 PË. Nuk e kam parë këtë dokument më herët, por përgjigja në  
4 pyetjen tuaj është jo.

5 PY. Dëshiroj që të shihni një pjesë konkrete të këtij  
6 raportit. Është faqja 216. Dua t'ju lexoj një pjesë që thotë,

7 "Fakti, domethënë, në këtë pikë Snezana" kishte dhe një  
8 përshkrim të një personi që ajo e përshkruan si z. Krasniqi.

9 Dhe nëpunësi që ka rishikuar këtë pasazh thotë që:

10 "Fakti që Snezana përshkruan z. Krasniqi që ishte në të  
11 40-at e veta dhe kishte flokë pa thinja e bën të pangjashme që  
12 ajo është takuar me Jakup Krasniqin, sepse z. Jakup Krasniqi  
13 në atë kohë ishte thuhetse 50 vjeç dhe i kishin dalë thinjat.  
14 Ka shumë të ngjarë që Snezana të ketë takuar me Gani  
15 Krasniqin, i cili ishte thuhetse 50 vjeç në atë kohë ose  
16 Skënder Krasniqin që ishte thuhetse 40 vjeç".

17 Kjo pyetje është ose kjo çështje është ngritur do të  
18 ngrihet në takimin tonë të ardhshëm.

19 A e lexoni këtë pjesë, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Do ju parashtroj pozicionin tonë në mënyrë të  
22 drejtpërdrejtë, Dëshmitar. Jakup Krasniqi nuk ka qenë i  
23 pranishëm në qendrën e ndalimit në Malishevë në periudha që  
24 janë përmendur prej jush. Pra, nga datat 17 deri 26 korrik  
25 1998 dhe ai, në fakt, nuk ka qenë asnjëherë në një qendër



1 ndalimi të UÇK-së. Ajo çfarë keni dhënë në deklaratat tuaj  
2 është opinionimi juaj se ju nuk keni qenë të pranishëm atje në  
3 korrik të vitit 1999 [sipas përkthimit] apo jo?

4 PË. Ka rrjedhur nga deklarata që kam marrë nga dëshmitarë.

5 PY. Po dhe është opinionimi juaj se atë çfarë ju kanë treguar  
6 personat me të cilët keni folur ishte informacion i saktë dhe  
7 ishte kryesisht informacion që ka ardhur nga Baljosevic nga të  
8 dy gratë me këtë mbiemër?

9 PË. Ishte përshtypje e përgjithshme në qytet edhe e kam thënë  
10 disa herë se unë nuk kam folur vetëm me ato dyja, por kam fol  
11 edhe me persona të tjerë.

12 PY. Dhe ju vetë nuk e keni identifikuar që të bëhet fjalë  
13 vërtet për z. Jakup Krasniqi apo jo?

14 PË. Jo, nuk është korrekte.

15 PY. Dhe duke marrë parasysh burimet që keni pasur në  
16 dispozicion si dhe kapacitetin për të kryer hetime penale nuk  
17 ishte e mundur që ju të verifikonit që bëhej fjalë për z.  
18 Krasniqi?

19 PË. Këtë e kam thënë shumë herë. Qëllimi ishte që të  
20 identifikonim personat të cilët, pra, ishin kidnapuar, që  
21 ishin vrarë.

22 PY. Dhe siç e thatë edhe më herët, ju nuk keni marrë  
23 deklarata nga të afërmit e tjerë, sa i takon fakteve që janë  
24 trajtuar.

25 PË. Po, kjo është e saktë.

Dëshmitari: W02153 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 98

1 PY. Dhe këtë gjë keni bërë apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe nuk keni folur asnjëherë vetë me z. Krasniqi për të  
4 dëgjuar anën e tij të historisë?

5 PË. Po. [sipas përkthimit]

6 Është e vërtetë. E kuptoj që ai është një person shumë  
7 trim dhe të gjithë e respektojnë atë.

8 PY. Ju na keni konfirmuar që nuk dinit se cila ishte  
9 struktura e komandës së UÇK-së në Malishevë në korrik të vitit  
10 1999, Dëshmitar. A është kështu?

11 PË. Po, e drejtë është kjo.

12 Z. ELLIS: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, po shkojmë drejt fundit të pyetjeve që kam për  
14 ju. Më herët, kur po ju bëja pyetje, thashë që ishte e  
15 thjeshtë që të bëhej një gabim në qoftë se bëhej fjalë për dy  
16 emra të njëjtë? Në përgjigjen tuaj juve thatë:

17 "Për të qenë i sinqertë me juve do të ishte Hoti dhe  
18 Krasniqi".

19 E kujtoni që e thatë këtë gjë?

20 PË. Po.

21 PY. Në përgjigje të një pyetje që unë bëra se deklaratat që  
22 kishit marrë, sa i takon z. Krasniqi dhe se si e kishte  
23 trajtuar z. Krasniqi informatorët, informuesit, përgjigja  
24 ishte që ata ishin të impresionuar me sjelljen e tij, a është  
25 e vërtetë kjo?

Dëshmitari: W02153 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 99

1 PË. Po. Përshtypja në të gjithë diskutimet ka qenë e tillë sa  
2 i takon njerëzve në Rahovec, pra, në raport me atë çfarë thoni  
3 për sjelljen e z. Krasniqi.

4 PY. Por në TPNJ ju përmendi edhe rrethanat e trajtimit nga z.  
5 Hoti?

6 PË. Po.

7 PY. A mos vallë po i ngatërroni përsëri Krasniqët dhe Hotët,  
8 Dëshmitar?

9 PË. Nuk kam dëgjuar asnjëherë asnjë ankesë për z. Krasniqi,  
10 për pjesët tjetër pastaj nuk di ç'të them.

11 PY. A mund të të lexoj një deklaratë tuajën në TPNJ?

12 PË. Po.

13 PY. Është 01 --

14 PË. E pranoj këtë që thoni; e pranoj, pa, nuk është e  
15 nevojshme. Ka kaluar një kohë e konsiderueshme tani.  
16 Megjithatë, ajo çfarë më kujtohet është që z. Krasniqi është  
17 një person goxha i respektuar ndërmjet njerëzve të atij  
18 qyteti.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
20 z. Ellis. Ndonjë pyetje?

21 Z. BAARLINK: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws,  
23 ndonjë pyetje?

24 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje, të nderuar  
25 Gjykatës.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z.

2 Kryegjykatës.

3 Pyetje nga Trupi Gjykses:

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita.

5 Kam disa pyetje për ju. Dua t'ju kërkoj falje  
6 paraprakisht që përgjigjet që mund të jepni mund të të  
7 përfshinë opinione ose përfundime. Megjithatë, sikurse i tha  
8 Kryegjykatësi Mbrojtjes së z. Thaçi dje ndonjëherë është e  
9 vështirë të bëhet dallimi ndërmjet opinioneve dhe fakteve.

10 Pyetjet e mia janë si më poshtë, z. Ledwidge:

11 Në deklaratën e parë të TPNJ-së nga nëntori i vitit 2000,  
12 për procesverbal është prova materiale 232 në faqen 7,  
13 401068157 ku keni folur për kidnapimet në Rahovec në verë të  
14 vitit 1998. Në këtë kontekst përmendi që UÇK-ja e kishte  
15 okupuar Rahovecin si qytet me 17 korrik 1998 dhe dy ditë më  
16 pas më datë 19 korrik forcat serbe filluan që të  
17 kundërsulmonin me artileri, duke mos bërë asnjë lloj dallimi  
18 ndërmjet luftëtarëve dhe joluftëtarëve. Domethënë, luftëtarëve  
19 të UÇK-së dhe civilëve shqiptarë të Kosovës.

20 Gjithashtu keni treguar TPNJ-së që nuk ka pas evidenca që  
21 UÇK-ja ka treguar ndonjë rezistencë edhe se një person të ka  
22 thënë ty se ata janë larguar dhe i lanë qytetarët që të  
23 përballëshin me pasojat. Besoj se kjo pjesë e fundit ju lexua  
24 nga z. Kehoe në kundërpjetjet e veta dje.

25 Pyetja e parë është kjo: a ju kujtohet që t'ia kenë thënë

1 këtë pjesën që sapo ju citova TPNJ-së?

2 PË. Për UÇK-në nuk kam pikë dyshimi që e kam thënë. Ky është  
3 pozicioni im edhe sot e kësaj dite.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja tjetër ka të bëjë me  
5 pyetjen pasues ose me paragrafin pasues. Pra, kur ju raportuat  
6 që kishin shumë qytetarë kosovarë, qindra qytetarë kosovarë që  
7 ishin vrarë dhe besoni se kishte dhe viktime të kidnapuara nga  
8 Serbia në atë zonë.

9 PË. Pra, për çfarë shifre e keni fjalën?

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë pyetje do t'ju bëj edhe  
11 unë, se ju thatë që kishte pak a shumë 150 shqiptarë që ishin  
12 kidnapuar. Atëherë pyetja është kjo: Z. Ledwidge, ju lutem, a  
13 mund të na thoni që kjo vrasje e 150 shqiptarëve civilë në  
14 Rahovec mund të kishte pasur ca pasoja?

15 PË. Sikurse e diskutuam edhe më herët, të nderuar Gjykatës,  
16 ishte çështja e hakmarrjes dhe një prej hipotezave që kishin  
17 personat e qytezës aty dhe që mua më dukej goxha bindëse ose  
18 të paktën është një hipotezë, goxha me gjasa për të ndodhur  
19 ishte që personat e zhdukur; A, ose ishin marrë në mënyrë të  
20 tillë që të kërkonin shkëmbimin me të burgosurit kosovarë dhe  
21 B, ose së dyti, ose plus kësaj të parës ishin vrarë si  
22 hakmarrje, pra, si kundërpeshë e vrasjeve që ishin kryer nga  
23 forcat serbe në datë 20, 21, 22, ose 19, 21. Domethënë të  
24 sulmit të serbëve se nuk më kujtohet se kur ka ndodhur sulmi i  
25 serbëve ekzaktësisht.

1 Domethënë ideja ishte që ose ishin marrë në mënyrë që të  
2 mund të shkëmbeheshin me civilët shqiptarë ose ishin vrarë  
3 sikundër masë ose si hakmarrje.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, baza e përfundimeve  
5 tuaja ose besimit tuaj ishin bisedat që kishit pasur me  
6 njerëzit e qytezës, kështu?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e  
9 fundit që kam për ju është kjo:

10 Z. Ledwidge, gjatë kohës që keni shërbyer në Kosovë në  
11 1999 [sipas përkthimit] dhe më pas në vitin '98 dhe '99. A e  
12 keni dëgjuar ndonjëherë termin "bashkëpunëtor" dhe në qoftë se  
13 po në çfarë konteksti?

14 PË. Jam thujse i sigurt që e kam dëgjuar. Kjo do ketë qenë  
15 në kontekstin e kidnapimeve që kanë ndodhur në fillim të vitit  
16 1999. Me aq sa më kujtohet fillimisht ishin Elshani dhe Morina  
17 dhe pastaj z. Xhafiqi - siç e thotë dëshmitari - gjatë kohës  
18 në mars, se nuk e kam përpara deklaratën.

19 Jam i sigurt që më është thënë në një moment të caktuar  
20 që kishte persona që mendoshin që ishin bashkëpunëtorë.

21 Po ashtu mbaj mend që në qytet ishte një parti që  
22 konsiderohej ose si pjesa e Rugovës ose si pjesa e Bukoshit  
23 dhe zakonisht ato njiheshin ose si tradhtarë ose si  
24 bashkëpunëtorë. Kaq më kujtohet, nuk më kujtohet gjë tjetër  
25 lidhur me këtë.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam pyetje  
2 të tjera.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
4 Mettraux.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju bëj disa pyetje  
8 që kanë të bëjnë me kohën kur ju ngarkuar detyra e hetimit të  
9 fatit të personave të zhdukur.  
10 PË. Po.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam përshtypjen që thatë  
12 që ishte fillimi i janarit 1999. Pyetje a parë që kam për juve  
13 është kjo: cilat burime u munduat që të kontaktonit në mënyrë  
14 të tillë që të përmbushnit mandatin që ju ishte ngarkuar?

15 PË. Objektivi kryesor do të kishte qenë patjetër UÇK-ja. Pra,  
16 burimet e UÇK-së që do të dinin se cili ishte fati i këtyre  
17 personave. Neve jemi penguar në çdo nivel të mundshëm lidhur  
18 me këtë. Sigurisht, domethënë, një tjetër pistë ishte  
19 intervistimi i dëshmitarëve ose ndonjëherë edhe fizikisht  
20 bënim kontrollin e zonave. Madje edhe më përpara sesa të  
21 emërohesha.

22 Më pas neve miratuar një strategji ose qasje të bashkimit  
23 të serbëve etnikë të shqiptarëve dhe romëve të zhdukur në një  
24 listë të vetme në mënyrë që tillë që ta konsolidonim këtë  
25 listë. Pra, në vend që të mundoheshim që të përfshiheshim në

1 çështje që do të përfshinin krimet lufte vendosëm që të kishim  
2 një qasje më neutrale dhe të përqendroheshim kryesisht tek  
3 gjetja e vendeve të trupave të vdekur.

4 Pra, nga shkurti e në vijim ishim të sigurt që kishin  
5 vdekur. Nuk është se ju thamë të afërmve këtë gjë, sepse nuk  
6 kishim prova për këtë besim tonën, por në diskutime me  
7 bashkëbiseduesit shqiptarë dhe bashkëbiseduesit serbë ne u  
8 përpoqëm të bënim një lloj shkëmbimi informacioni. Sikurse e  
9 them në një prej deklaratave të mia kemi krijuar një komision  
10 me persona që i besonim dhe me të cilit kishim marrëdhënie të  
11 mira që ne mendonim që mund të kishte qasje në një pjesë të  
12 këtij informacioni. Domethënë, kjo është qasja që ne përdorëm  
13 që në momentin që shkuam, pra, shumë shpejt pasi u vendosëm  
14 besonim që këta persona ishin të vdekur. Dhe kjo filloi që të  
15 jepte frytet e veta në mars, në fillim të marsit kur siç e  
16 thashë edhe më përpara u takova nga një person, nga një oficer  
17 i inteligjencës serbe që ishte zëvendëskomandanti i policisë  
18 në Prizren.

19 Kam pasur një takim, të paktën te një takim, një takim  
20 goxha të gjatë ku kam shënime të detajuara dhe ne diskutuam në  
21 mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, ne u zhvendosëm nga kontaktimi  
22 ose marrja e informacionit nga burimet e UÇK-së dhe u  
23 angazhuam më tepër me dy anë të tjera. Domethënë, shoqërinë  
24 civile, kështu që më duhet të them që unë asokohe i kam thënë  
25 goxha shpresa përfshirjes së këtij individi. Arsyeja për këtë



1 gjë ishte që le ta them kështu që ishte një lloj gjesti  
2 mirëbesimi dhe në këtë kuadër ai na dha shumë dosje, ndoshta  
3 52 dosje, pak a shumë, që tregonte fatin dhe vendndodhjen e  
4 viktimave shqiptare të vrasjeve të cilat u nënvizuan nga  
5 kolegët. Pra, më 19 korrik dhe deri më 21 korrik.

6 Këto ishin dosjet të cilat përbëheshin nga fotografi. Me  
7 sa mbaj mend jepeshin rrethanat e vdekjes edhe hollësitë të  
8 tjera forenzike si dhe vendet ku gjendeshin varret ose ku  
9 ishin varrosur këto persona.

10 Ne nuk na u lejua që t'i mbanim ato. Faza tjetër ishte që  
11 t'i shkëmbejin këto, pra, ne nuk kishim zgjidhje tjetër dhe  
12 ideja ishte që këto informacione të mund t'i shkëmbejmë me  
13 UÇK-në duke mos përfshirë asnjë lloj përgjegjësie penale. Por  
14 ideja kryesore dhe qëllimi kryesor ishte që të gjenim vendim  
15 se ku ishin varrosur këta personi. Kjo ishte strategjia e  
16 përdorur. Domethënë që të kontaktonim me UÇK-në, me shoqërinë  
17 civile dhe pastaj u zhvendosëm në atë çfarë ne na u duk si një  
18 mundësi, pra, që të bëhej shkëmbimi i trupave.

19 Kjo ishte në faza shumë të hershme në momentin kur ne u  
20 detyruam që të largoheshim prej aty.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë kohës kur keni kryer  
22 këto funksione, a keni marrë edhe informacione ose informata  
23 në përgjigje të të cilave duhej që të merrnit veprime sa i  
24 takon vendit ku mund të gjendeshin personat të tillë të  
25 zhdukur?

1 PË. Jo.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Deri në masën kur keni  
